



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 608 Akti

Nr. 741 Vendimi
Tiranë, më 11.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 8.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bezart Kaçkini**, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Bezart Kaçkini, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkani, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkani do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Bezart Kaçkani, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 28.2.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Bezart Kaçkani; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit, në datën 5.3.2024.
8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Bezart Kaçkani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 6.3.2024.
9. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 30.1.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

10. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11. Z. Bezart Kaçkini ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

Procesi i rivlerësimit/hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bezart Kaçkini, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke marrë në analizë:

- i.** Raportin e ardhur nga ILDKPKI-ja dhe dosjen për vlerësimin e pasurisë:

¹ 41. Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- deklaratën *Vetting* të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003;
- dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja;
- dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016”;
- praktikën e rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit, znj.E.K , e administruar nga Komisioni;
- deklaratimet e subjektit dhe provat e dërguara në përgjigje të pyetësorëve.

ii. Raportin e administruar nga AKSIK-ja për kontrollin e figurës:

- formulari i plotësuar i kontrollit të figurës;
- hetimi administrativ nga Komisioni.

iii. Raportin profesional të administruar nga KLGJ-ja për vlerësimin profesional:

- dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga KLGJ-ja.

iv. Denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016:

- dokumentacioni i depozituar nga denoncuesit pranë Komisionit.

16. Me vendimin nr. ***, datë 18.9.2023, të trupit gjykues është administruar dosja e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. E.K , e cila, me detyrë prokurore është hetuar nga Komisioni, i cili për këtë subjekt ka shpallur vendimin nr. 181, datë 18.7.2019, ku është vendosur konfirmimi në detyrë i saj. Ky vendim i Komisionit nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë.

17. Komisioni e pyeti subjektin e rivlerësimit nëse ishte dakord dhe i qëndronte deklaratimeve të bëra nga bashkëshortja e tij gjatë procesit të rivlerësimit, të cilit ajo i është nënshtruar më parë. Kjo me qëllim administrimin dhe përdorimin nga trupi gjykues të përgjigjeve dhe provave të depozituara nga bashkëshortja, të cilat korrespondojnë me pasuritë e trajtuara më parë dhe të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit.

18. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se: *“Konfirmoj të gjitha provat e dorëzuara nga bashkëshortja ime znj. E.K . Mbaj të njëjtin qëndrim me të, por në vazhdim do të japë përgjigje të detajuara për pasurinë apartament, i cili është pasuri e vënë nga ana ime përpara martesës”*.

19. Subjekti Bezart Kaçkini është emëruar në datën 5.10.2006 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka deklaruar se ka banuar në banesën në pronësi të xhaxhait H.K, ndodhur në K, A, *** Durrës. Në vitin 2007 është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, duke deklaruar se ka qëndruar në ish-hotel “****” kundrejt një pagese mujore. Në prill 2010 është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka deklaruar se ka jetuar tek ***, apartamentet e oficerëve, në pronësi të babait.

20. Subjekti është martuar në nëntor 2012 dhe ka deklaruar se ka banuar në apartamentin e blerë në pronësi të tij, ndodhur në Y, rruga “****”, pallatet “****”.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Apartament banimi në Y, komuna K

1.1 Subjekti ka deklaruar pasurinë apartament banimi nr. ***, z. k. ***, në Y, komuna K, qarku Tiranë, me sip. 78.33 m², blerë me kontratën e shitblerjes datë 30.11.2011, mes shitësit “ ****” dhe blerësit Bezart Kaçkini, në zbatim të kontratës së porosisë së datës 5.1.2010. Vlera: 32,260 euro. Zotërimi: 100%. Pagesa e bërë sipas mandatarkëtimit datë 5.1.2010, pranë Intesa Sanpaolo Bank, Tiranë.

1.2 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet nga paga dhe huamarrje. Për huamarrjen është deklaruar kontrata e huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.1.2010, mes huadhënësit E.D dhe huamarrësit Bezart Kaçkini, me kohëzgjatje deri më 4.1.2015, e shlyer, si dhe kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2010, mes huadhënësit B.K dhe huamarrësit Bezart Kaçkini, me kohëzgjatje deri më 4.1.2022.

Hetimi i Komisionit

1.3 Për të vërtetuar deklaramet e bëra për këtë pasuri janë paraqitur dokumentacionet ligjore provuese².

1.4 ZVRPP Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2019³, konfirmon se shtetasi Bezart Kaçkini ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me sip. 78.33 m², Y .

1.5 Në DPV-në e vitit 2010 subjekti ka deklaruar: *“Blerje apartamenti banimi në komunën K, lagjja “****”, rruga për në Y, shk. ***, tipi ***, kati ***, sip. 91.1 m². Vlera 38.260 euro. Kontrata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.1.2010. Burimi, kursime dhe huamarrje”*. Ndërsa në DPV-në e vitit 2011 subjekti e ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie në shumën 32,260 euro.

1.6 Sipas kontratës së porosisë me shoqërinë “****”, datë 5.1.2010, vlera e kontratës rezultoi 38,260 euro. Sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2011, vlera e blerjes së kësaj pasurie është 5,270,000 lekë (duket si ekuivalenti i vlerës 38,260 euro).

1.7 Konstatohet një mospërputhje e vlerës së kësaj pasurie apartament të deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2011 prej 32,260 euro, në raport me deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 dhe kontratës së shitjes datë 30.11.2011, në vlerën 38,260 euro.

1.8 Lidhur me këtë mospërputhje është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se: *“Ashtu si rezulton edhe nga të gjitha aktet bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, aktet e dorëzuara në ILDKPKI dhe ashtu sikurse bashkëshortja ime ka shpjeguar gjatë procesit të saj të rivlerësimit, apartamenti në fjalë, i ndodhur në Y, K, është porositur dhe blerë në vlerën 38,260 euro. Deklarimi i vlerës së apartamentit në shumën 32,260 euro është lapsus. Ky apartament është porositur me anë të kontratës së porosisë për një vlerë 38,260 euro. Sipas nenit 2 të kësaj kontrate dhe sipas dokumentit mandat bankar në Intesa Sanpaolo Bank, shuma 38,260 euro është paguar në llogarinë bankare të shoqërisë sipërmarrëse në momentin e lidhjes së kësaj kontrate në datën 5.1.2010. Për sa i përket vlerës së pasqyruar në kontratën e shitjes, e cila është në shumën 5,270,000 lekë, ajo përbën ekuivalentin e shumës së parave 38,260 euro. Këtë fakt e kam sqaruar edhe në deklaramin e dhënë në datën 4 dhjetor të vitit 2014 kur jam pyetur në ILDKPKI.*

² Shihni dokumentacionin në dosjen e bashkëshortes së subjektit: (1) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme apartament nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2011, blerës Bezart Kaçkini, të apartamentit me sip. 78.33 m², ndodhur në Y, Tiranë, në vlerën 5,270,000 lekë, e parapaguar nga blerësi më 5.1.2010 kur është lidhur kontrata e porosisë + praktika kontratës; (2) certifikatë pronësie nr. ***, datë 14.12.2011 + kartel pasurie, për apartamentin me sip. 78.33 m² në emër të Bezart Kaçkinit; (3) kontratë porosie datë 5.1.2010, midis Bezart Kaçkini dhe shoqërisë “****”, për apartament me sip. 91.1 m², ndodhur në Y, Tiranë, në vlerën 38,260 euro, vlerë të cilën blerësi e ka paguar me lidhjen e kontratës në llogarinë e sipërmarrësit; (4) nxjerrje llogarie ISP Bank, ku vërtetohet se Bezart Kaçkini ka kryer pagesën për blerjen e apartamentit në vlerën 38,260 euro, më 5.1.2010, me përfitues shoqërinë “****”.

³ (1) Shihni shkresën e ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Kartela e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 78.33 m², me pronar Bezart.B.Kaçkini; (2) kartela e pasurisë nr. ***, z. k. ***, me sip. 78.33 m² në pronësi të “****” sh.p.k.; (3) mandatpagesë në vlerën 450 lekë dhe 7,983 lekë, datë 6.12.2011, Credins Bank; (4) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme apartament nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2011, blerës Bezart Kaçkini, i apartamentit në Y, Tiranë, në vlerën 5,270,000 lekë, e parapaguar nga blerësi në datën 5.1.2010 kur është lidhur kontrata e porosisë; (5) certifikatë pronësie nr. ***, datë 3.11.2011 + kartelë pasurie, për apartamentin me sip. 78.33 m² në emër të shoqërisë “****” + planimetria e apartamentit.

Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit

1.9 Komisioni hetoi lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Tiranës. Bazuar në Udhëzimin nr. 3, datë 3.2.2010, të Këshillit të Ministrave, rezultoi se kostoja mesatare e ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi për qytetin e Tiranës ishte 28,333 lekë/m². Në këtë mënyrë kostoja totale për apartamentin do të rezultonte në vlerën 2,219,324 lekë (28,333 lekë/m² x 78.33 m²).

1.10 Gjithashtu, referuar të njëjtit udhëzim, rezultoi se vlera në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2010 për zonën Y ishte në vlerën 68,000 lekë/m². Në këtë mënyrë, vlera e tregut për apartamentin do të rezultonte në shumën 5,326,440 lekë (68,000 x 78.33).

1.11 Sa më sipër, rezulton se vlera e blerjes së kësaj pasurie (5,270,000 lekë) është më e lartë se kostoja mesatare e ndërtimit (2,219,324 lekë) dhe pak më e ulët se vlera mesatare e tregut të lirë të apartamenteve (5,326,440 lekë).

1.12 Bazuar në vërtetimin e datës 6.2.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresës nr. *** prot., datë 5.2.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte ndjekur ndonjë çështje gjyqësore me palën shitëse të pasurisë apartament.

Në lidhje me mënyrën dhe kohën e pagesës

1.13 Komisioni konstatoi se pagesa për blerjen e kësaj pasurie është bërë sipas veprimit dhe mandatit bankar pranë Intesa Sanpaolo Bank, më 5.1.2010, në vlerën 38,260 euro.

1.14 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë⁴ edhe një kopje të mandatit të depozitimit në Intesa Sanpaolo Bank, datë 5.1.2010, me koment *“Bezart Kaçkini/Blerje apartamenti Y/ komuna K, Tiranë”* (vlera e depozitimit 38,260 euro).

1.15 Fakti i mësipërm është konfirmuar edhe nga shoqëria “****”, e cila, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, i ka bashkëngjitur të njëjtin mandat depozitimi bankar shkresës së saj⁵.

Në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë

1.16 Komisioni hetoi lidhur me deklarimin e subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie që janë kursimet e tij nga paga dhe huamarrjet nga znj. E.D dhe z. B.K (si persona të tjerë të lidhur me cilësinë e huadhënësit).

1.17 Bazuar në dosjen e ILDKPKI-së janë administruar:

- deklarata para fillimit të detyrës (data e emërimit në detyrë 4.10.2006) si dhe DPV-të e paraqitura pranë ILDKPKI-së;
- deklarata noteriale ku rezulton se subjekti i rivlerësimit i ka marrë hua në vlerën 12,000 euro, në datën 4.1.2010, shtetases E.D, pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale⁶;
- kontratë huaje pasurie e luajtshme të holla, midis huamarrësit subjekti i rivlerësimit dhe huadhënësit B.K, për një shumë prej 12,000 euro, të marrë më 4.1.2010, me afat deri më 4.1.2022, pa kamatë dhe interesa. Shuma është marrë jashtë zyrës noteriale⁷.

⁴ Shihni dokumentin në dosjen e ILDKPKI-së të subjektit.

⁵ Shihni përgjigjen e shoqërisë “****” në dosjen e bashkëshortes së subjektit. Shkresë shoqëria “****”, datë 5.6.2019.

⁶ Deklarata noteriale nr. ***, datë 5.1.2010, ku rezulton se Bezart Kaçkini deklaroi se ka marrë hua në vlerën 12,000 euro, në datën 4.1.2010, shtetases E.D, pagesë e kryer jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu edhe dokumentacion në gjuhën angleze në lidhje me punësimin e shtetases E.D.

⁷ Shihni në dosjen e bashkëshortes së subjektit: (1) kontratë huaje pasurie e luajtshme të holla nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2010, midis huamarrësit Bezart Kaçkini dhe huadhënësit B.K, për një shumë prej 12.000 euro, të marrë më 4.1.2010, me afat deri më 4.1.2022, pa kamatë dhe interesa. Kjo hua është dhënë pa garanci hipotekore. Vlera është marrë jashtë zyrës noteriale; (2) vërtetim nr. ***, datë 22.11.2016 nga Ministria e Mbrojtjes, ku rezulton se B.K ka shërbyer si ushtarak aktiv në F.A, deri më 1.8.2003, ku i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare; (3) vërtetim nr. ***, datë 22.11.2016 nga Reparti Ushtarak nr. *** “Për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”; (4) vërtetim nr. ***, datë 13.12.2013, nga Ministria e Mbrojtjes, mbi vjetërsinë në shërbimin dhe pagën mesatare neto referuese për shtetasin B K; (5) vendim për caktim pensioni nga ISSH-ja për B.K, nr. ***, datë 3.7.2015, nr. *** dhe ***; (6) librezë pune për znj. Z.D, ku rezulton se ka qenë e punësuar që prej vitit 1981 deri në vitin 2010.

1.18 Në formularin e deklaratës *Vetting* tek seksioni “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë ekzistuese huaje mes huadhënësit B.K dhe huamarrësit Bezart Kaçkini, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2010. Kohëzgjatja deri në datën 4.1.2022, pa interes. Qëllimi blerja e apartamentit në komunën K, Tiranë. Shuma e detyrimit 12,000 euro”.

1.19 Kurse tek seksioni “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: “Kontratë ekzistuese huaje mes huadhënësit B.K dhe huamarrësit Bezart Kaçkinit nr. *** rep., *** kol., datë 6.1.2010. Kohëzgjatja deri në datën 4.1.2022, pa interes. Qëllimi blerja e apartamentit në komunën K, Tiranë. Burimi i krijimit të shumës së dhënë hua kursime të familjes. Bashkëlidhur vërtetim i lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, vendim për caktim pensioni të parakohshëm vendim për rishqyrtim të pensionit, librezë pune. Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2010. B.I.K, babai, huadhënësi”.

Huaja e marrë nga babai B.K

1.20 Subjekti ka deklaruar hua të marrë nga babai B.K, në shumën 12,000 euro (ekuivalenti në lekë në datën 5.1.2010 është 1,653,600 lekë). Burimi i krijimit të shumës së dhënë hua janë deklaruar kursime të familjes.

1.21 Komisioni, pasi administroi praktikën e bashkëshortes së subjektit, konstatoi se në pyetësorin e datës 3.6.2019 bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e z. B.K dhe personave të tjerë që kanë jetuar më të për periudhën gjatë së cilës janë krijuar kursimet e dhëna hua në shumën 12,000 euro. Në përgjigjen e datës 11.6.2019, bashkëshortja e subjektit ka dorëzuar dokumentacion justifikues⁸.

1.22 Lidhur me mundësinë e huadhënësit B.K është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** deklaroi se⁹: “Të ardhurat e akumuluar për periudhën 1994 – 2009 nga familjarët e mi kanë qenë 6,726,044 lekë. Këto janë dokumente që babai ka mundur të gjejë, por ai më ka deklaruar se ka pasur edhe të ardhura të tjera p.sh. nga firmat rentiere, apo interesat bankarë. Prindërit e mi gjithmonë kanë pasur të ardhura si rezultat i punësimit të tyre si ushtarak karriere babai dhe farmacistë nëna. Ata gjithmonë i kanë investuar paratë e kursyera në depozita kursimi apo letra me vlerë, por për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk ka mundur të sigurojë të gjithë dokumentacionin (p.sh. dokumentacion nga ish-Banka e Kursimeve). Nga një përlllogaritje e përafërt e kryer nga ana ime rezulton se vetëm nga interesat bankarë në periudhën 2004 – 2009 babai im ka përfutuar afro 1,000,000 lekë. Duke

⁸ Shihni përgjigjen e bashkëshortes së subjektit në praktikën e administruar nga Komisioni për këtë subjekt. B.K: (1) kartela personale e oficerit me dosje nr. *** lëshuar nga Q.P.R me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2019 (tetë fletë); (2) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019 lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 01.01.1994 deri më 28.2.1995 (dy fletë); (3) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019 lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.11.1996 – 31.12.2002; (4) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.2.2003 deri më 30.11.2003 dhe 1.1.2005 – 31.3.2008; (5) vërtetim nga Qendra e Personel Rekrutimit për trajtim me pagesë kalimtare të ushtarakut në rezervë datë 7.6.2019 për periudhën 2003 – 2004; (6) vërtetim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër me nr. *** prot., datë 26.2.2019 për pension ushtarak të parakohshëm për periudhën 1.8.2005 – 17.6.2015 dhe më pas në pension pleqërie.

Z.D: (1) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.3.1995 deri 31.3.2000; (2) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.6.2006 – 31.12.2009 dhe shkresë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Shkodër nr. *** prot, datë 20.2.2013; (3) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.1.2003 – 31.12.2005; (4) vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore nr. *** prot., datë 5.6.2019, lëshuar nga Dega e Arkivës së Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër për periudhën 1.11.1996 – 31.12.2002; (5) vërtetim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër nr. *** prot., datë 26.2.2019 për trajtim pleqërie;

E.K: (1) vërtetim nga Ministria e Drejtësisë nr. *** prot., datë 17.10.2016, në lidhje me pagat nga data 9.10.2008 deri në datën 20.9.2016.

⁹ Shihni përgjigjen e subjektit sipas pyetësorit nr. *** në dosjen e Komisionit.

u bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹⁰ vlerësoj se dokumentacioni i dorëzuar gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëshortes sime është i mjaftueshëm për të vërtetuar burimin e ligjshëm të shumës së huazuar nga babai im (pa përfshirë të ardhurat nga interesat bankarë apo të ardhura të tjera siç janë edhe të ardhurat nga shoqëritë rentiere¹¹). Për lehtësi kam përgatitur edhe një tabelë të thjeshtë financiare, nga e cila rezulton se babai im ka pasur mundësi për të më huazuar shumën 12,000 euro ose 1,653,600 lekë. Analizën financiare e kam kryer për vitet 2005 – 2009, periudhë gjatë të cilës unë nuk kam jetuar me prindërit (pra, periudha pasi fillova Shkollën e Magjistraturës)”.

1.23 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konstatohet se personat e tjerë të lidhur B.K, Z.D dhe E.K kanë pasur në total të ardhura në shumën 6,726,044 lekë¹² (të ardhurat përgjatë periudhës 1994 – 2009, duke mos përfshirë asnjë lloj shpenzimi).

1.24 Shtetasit e mësipërm nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin tregtar, si dhe nuk konfirmohet që këta shtetas kanë aktivitet privat të regjistruar në emër të tyre¹³.

1.25 Komisioni analizoi mundësinë financiare të familjes prindërore të subjektit për t’i dhënë atij huan prej 12,000 euro në janar të vitit 2010. Analiza është bërë për periudhën 2005 – 2009 për arsye se subjekti, sipas deklaramentit të tij në përgjigje të pyetësorit nr. ***, në atë periudhë kur ka filluar edhe Shkollën e Magjistraturës (2005) nuk ka jetuar më me prindërit. Kursi i këmbimit për vlerën e huas është marrë ai i datës 5.1.2010 sipas Bankës së Shqipërisë (137.8 lekë/euro).

Analiza e mundësisë së familjes prindërore për huan 12,000 euro subjektit (2005 – 2009)

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura B.K 2005 – 2009	2,368,073
Të ardhura Z.K 2005 – 2009	991,102
Të ardhura E.K 2005 – 2009	593,784
Të ardhura totale 2005 – 2009	3,952,959
Shpenzime jetese 3 persona 2005 – 2009	1,886,922
Huadhënie subjektit 2010 - 12,000 euro	1,653,600
Mundësia financiare	412,437

Nga analiza financiare familja prindërore kishte burime të ligjshme të mjaftueshme, që me të ardhurat e saj të përballonte shpenzimet e jetesës, si dhe t’i jepte subjektit huan në vlerën 12,000 euro në datën 5.1.2010.

¹⁰ Në vendimin nr. 02/2013 Kolegji ka theksuar se: “17.12 Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, sipas së cilit kërkon përfshirjen si shpenzim në analizën financiare të personit tjetër të lidhur të të gjitha investimeve që ai rezulton se ka kryer, të cilat në rastin konkret lidhen me përfshirjen si shpenzim të shumës 270.000 lekë gjendje në një depozitë në ABI Bank të krijuar në nëntor të vitit 2008, Kolegji analizon sa vijon. 17.13 Kolegji në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në referim të jurisprudencës së deritanishme, lidhur me interpretimin e kësaj dispozite, nuk e konsideroi si shpenzim me të cilin duhej ngarkuar analiza financiare e personit tjetër të lidhur vlerën prej 270.000 lekësh, të ndodhur në llogarinë bankare në NBG, (sot Banka Amerikane e Investimeve), në emër të tij. Kolegji vlerësoi se për personin tjetër të lidhur analiza financiare duhet shtrirë në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, e cila është objekt i marrëdhënies së dhurimit, në këtë rast shumat respektive të përshkruara më lart. Pjesë e kësaj analize do të jenë edhe shpenzimet e kryera prej tij për të përballuar kostot e jetesës, si një e dhënë bazike e përdorur tashmë për analizimin e mundësive financiare të personave të tjerë të lidhur, sipas jurisprudencës së Kolegjit. Ky vlerësim konsiderohet se përmbush kriteret e një vlerësimi të arsyeshëm e proporcional, lidhur me mundësitë e personave të tjerë të lidhur, duke krijuar një panoramë të mjaftueshme për marrjen e një e një vendimi, lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të pasurive të dhëna hua apo dhuruar sipas rastit”.

¹¹ Bashkëlidhur kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2023, lëshuar nga Sh.H.A, informacion nga i cili rezulton se shtetasi B.K, kreditor në shoqërinë “***” ka depozituar në datën 27.7.1996 shumën e parave 600,000 lekë dhe ka tërhequr interesa datë 28.10.1997 shumën 240,000 lekë dhe 30.6.2008 ka marrë shumën 36.720 lekë.

¹² Shihni vendimin nr. 181, datë 18.7.2019, të Komisionit, për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit.

¹³ Shihni përgjigjet e QKR-së dhe Drejtorisë së Tatimeve në dosjen e bashkëshortes së subjektit.

1.26 Gjithashtu, Komisioni analizoi edhe periudhën 1994 – 2009. Në këtë analizë, shpenzimet e jetesës përfshijnë edhe subjektin deri në vitin 2004.

Analiza e mundësisë së familjes prindërore për huan 12,000 euro subjektit (1994 – 2009)

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura B.K 1994 – 2009	4,360,325
Të ardhura Z.K 1994 – 2009	1,771,935
Të ardhura E.K 2008 – 2009	593,784
Të ardhura totale 1994 – 2009	6,726,044
Shpenzime jetese familja e subjekti 1994 – 2009	4,624,179
Huadhënie subjektit 2010 - 12,000 euro	1,653,600
Mundësia financiare	448,265

1.27 Nga analiza financiare, familja prindërore kishte burime të ligjshme të mjaftueshme, që me të ardhurat e saj, të përballonte shpenzimet e jetesës, si dhe t'i jepte subjektit huan në vlerën 12,000 euro në datën 5.1.2010. Analiza financiare lidhur me mundësinë e huadhënësit si person tjetër i lidhur është hartuar bazuar dehe në praktikën e Kolegjit, duke u shtrirë në drejtim të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë, e cila është objekt i marrëdhënies së huas. Pjesë e analizës financiare janë vlerësuar të ardhurat ndër vite duke zbritur shpenzimet e kryera për të përballuar kostot e jetesës nga huadhënësi dhe familjarët e tij.

1.28 Sa më sipër, huaja e marrë nga babai i subjektit në datën 5.1.2010 është konsideruar si e ardhur e ligjshme dhe, për rrjedhojë, si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit nga subjekti në vitin 2010.

Huaja e marrë nga shtetasja E.D

1.29 Subjekti ka deklaruar hua të marrë kushërirës së tij E.D , në shumën 12,000 euro (ekuivalenti në lekë në datën 5.1.2010 është 1,653,600 lekë).

1.30 Në DPV-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: *“Hua me qëllim blerjen e apartamentit në shumën 12,000 euro, pa interes e marrë nga shtetasja E.D me kontrate noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.1.2010, me afat deri në datën 4.1.2015 dhe shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit -4,000 euro. Gjendja e detyrimit e mbetur pa shlyer -8,000 euro”*.

1.31 Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar shlyerje nga kjo hua në shumën 3,000 euro dhe gjendje të mbetur detyrimi në shumën 5,000 euro.

1.32 Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar shlyerje nga kjo hua në shumën 3,000 euro dhe gjendje të mbetur detyrimi në shumën 2,000 euro.

1.33 Në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shlyerje nga kjo hua në shumën 2,000 euro dhe gjendje të mbetur detyrimi në shumën 0 (zero).

1.34 Komisioni konstatoi se në pyetësorin e datës 3.6.2019 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues¹⁴ lidhur me mundësitë e huadhënësës.

1.35 Lidhur me mundësitë për huadhënie të personit tjetër të lidhur E.D , është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** deklaroi: *“Në përgjigje të pyetësorit të*

¹⁴ Shihni përgjigjen e bashkëshortes së subjektit në dosjen e administruar nga Komisioni për këtë subjekt: (1) vërtetim datë 5.6.2019, lëshuar nga organizata jofitimprurëse “P.A.Ch.D” për shtetasen E.D, kopje të librezës së punës në emër të saj, si dhe *statement*-in bankar për vitin 2008; (2) kontratë pune datë 30.12.2009 me ***, *statement* bankar, si dhe vërtetim të lëshuar nga Drejtoria e Kontributeve Shoqërore të ISSH-së datë 5.6.2019, ku ky i fundit sipas komunikimit, për shkak të statusit të punëdhënësit përbëjnë të vetmin dokument të detyrueshëm që i kërkohet për ta paraqitur tek administrata sipas kushteve të kontratës së punës.

*datës 3.6.2019, bashkëshortja ime ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për dhënien e kësaj huaje. Znj. E.D ka qenë e punësuar pranë P.A dhe ka pasur kontrata shërbimi me *** Shqipëri. Të ardhurat neto të realizuara, një pjesë e mirë e të cilave ka kaluar edhe në llogari bankare në vitet 2005 – 2009, janë 3,000,000 lekë, shumë më se e mjaftueshme për të justifikuar huan. Duhet të theksoj që prindërit e saj (daja im H. D. dhe bashkëshortja e tij D. D.) kanë pasur të ardhura të konsiderueshme si rezultat i punësimit të tyre në sektorin publik dhe privat”.*

1.36 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, huadhënësja E.D ka qenë e punësuar pranë “P.A ” për periudhën gusht 2005 – nëntor 2008.

1.37 Sipas vërtetimit të sjellë nga P.A.Ch.D, vërtetohen të ardhura neto totale për periudhën gusht 2005 – nëntor 2008, në shumën 1,241,567 lekë. Ndërkohë, nga librezat e kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor vërtetohen të ardhura neto totale për periudhën gusht 2005 – korrik 2008, në shumën 1,021,568 lekë. Në dokumentacionin e sjellë është edhe një *statement* i llogarisë bankare në emër të shtetases E.D tek Intesa Sanpaolo Bank, në të cilën për periudhën shtator 2008 – nëntor 2008 ka kaluar në total shuma 165,000 lekë. Deri në këtë moment, Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme pagat e vërtetuara nga vërtetimi i lëshuar nga “P.A.Ch.D”, të cilat konfirmohen edhe në librezën e kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor (gusht 2005 – korrik 2008), në vlerën 1,021,568 lekë (e barasvlefshme me 8,348 euro). Kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme për huadhënësen E.D .

1.38 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, huadhënësja E.D ka pasur kontrata shërbimi me *** Shqipëri që nga nëntori 2008 e në vazhdim.

1.39 Vërtetohet se në llogarinë bankare në emër të shtetases E.D tek Intesa Sanpaolo Bank për periudhën dhjetor 2008 – dhjetor 2009 ka kaluar në total shuma 1,926,130 lekë.

1.40 Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve¹⁵, në përgjigjen e saj ka deklaruar se nuk administrojnë të dhëna për këtë shtetase për periudhën 2008 – 2009.

1.41 Komisioni iu drejtua përsëri Drejtorisë së Tatimeve me shkresën nr. *** prot., datë 23.1.2024, dhe nr. *** prot., datë 12.2.2024, lidhur me pagimin e detyrimeve për të ardhurat nga marrëdhënia kontraktuale e huadhënëses (E.D) me ***, e cila në përgjigjen¹⁶ e saj nuk ka konfirmuar pagimin e detyrimeve nga kjo shtetase.

1.42 Kontratat e shërbimit të lidhura mes *** dhe shtetases E.D , në pikën 7 të saj përcaktojnë se: *“Për tatimin mbi të ardhurat punëmarrësi është vetë përgjegjës për të gjitha taksat dhe *** nuk do të bëjë asnjë ndalesë për qëllime të pagesës së tatimit mbi të ardhurat”.*

1.43 Bazuar në nenin 8, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, paragrafi 2.3.1., citohet se: *“Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi)”.*

1.44 Deri në momentin e mbylljes së rezultateve të hetimit, të ardhurat e përfituara nga kontratat e shërbimit të huadhënëses E.D me *** për periudhën dhjetor 2008 – dhjetor 2009, nuk u konsideruan nga Komisioni si burim i ligjshëm për huadhënien e deklaruar nga subjekti, si të dhënë nga shtetasja E.D , për shkak se nuk vërtetohet pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

¹⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.5.2019, të DPT-së, në dosjen e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

¹⁶ Shihni përgjigjen e DRT-së në shkresat nr. *** prot., datë 12.2.2024 dhe nr. *** prot., datë 28.2.2024, në dosjen e Komisionit.

1.45 Komisioni analizoi mundësitë financiare të huadhënësës E.D për huadhënien e shumës së deklaruar prej 12,000 euro.

1.46 Nga analiza financiare huadhënësja E.D kishte mundësi të huazonte vetëm shumën 5,313 euro me të ardhura të ligjshme subjektit në datën 5.1.2010, si dhe të mbulonte shpenzimet e jetesës për periudhën gusht 2005 – korrik 2008.

1.47 Në lidhje me shlyerjen e detyrimit ndaj huadhënësës E.D në vitin 2010, bazuar në deklarinimin e subjektit në DPV-në e vitit 2010, Komisioni hartoi analizën financiare të mundësisë së subjektit për shlyerjen e shumës 4,000 euro si më poshtë:

Analiza e mundësisë së pagesës së shumës 4,000 euro E.D t në vitin 2010

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 6.1.2010 – 31.12.2010	939,890
Të ardhura totale 6.1.2010 – 31.12.2010	939,890
Shpenzime jetese 6.1.2010 – 31.12.2010	136,620
Shpenzime qiraje në Tropojë subjekti 6.1.2010 – 31.12.2010	9,000
Shpenzime mobilimi 6.1.2010 – 31.12.2010	50,000
Shpenzime udhëtimi 6.1.2010 – 31.12.2010	5,552
Shpenzime totale 6.1.2010 – 31.12.2010	201,172
Ndryshim likuiditeti 6.1.2010 – 31.12.2010	-321,724
Pagese 4,000 euro E.D – 2010	555,240
Mundësia financiare	505,201

1.48 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e vlerës 4,000 euro shtetasës E.D , si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

1.49 Në lidhje me mundësitë e shlyerjes së detyrimit ndaj huadhënësës E.D në vitet 2011 – 2013, referuar rezultatit financiar pozitiv për këto vite, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e këtyre shumave.

Në lidhje me kursimet nga paga

1.50 Duke konsideruar dy huat dhe vlerën me të cilën është blerë apartamenti, diferenca e paguar me kursimet nga paga rezulton të jetë 14,260 euro (38,260 euro - 12,000 euro - 12,000 euro).

1.51 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë se cilës periudhë i përkasin këto kursime.

1.52 Përgjatë periudhës 1.1.2010 – 5.1.2010, në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur asnjë tërheqje.

1.53 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “*Para cash në shtëpi*” në shumën 800,000 lekë, ndërsa në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 – 2007, ai nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të kësaj vlere.

1.54 Në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Para cash nga llogaria rrjedhëse në shtëpi 250,000 lekë*”.

1.55 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*. Gjithashtu, as në DPV-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*.

1.56 Komisioni, pas administrimit të dosjes së bashkëshortes së subjektit, konstatoi se në përgjigjen e saj në datën 12.6.2019¹⁷ ajo ka shpjeguar se: “*Bashkëshorti sqaron që mosdeklarimi i pakësimit apo shtesës së saj duhet të ketë ardhur nga paqartësitë se si dhe ku duhej ta deklaronte në formular (nga mungesa e një rubrike të posaçme për këtë deklaram) dhe mungesa e përvojës në plotësimin e deklaratës*”.

1.57 Për këtë është pyetur edhe subjekti i rivlerësimit, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar: “*Kursimet nga paga që kanë shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie janë kursimet e realizuara nga paga e ime ndër vite. Në muajt e parë të vitit 200, kam hapur llogari bankare rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank, po për shkak të krizës botërore ekonomike-bankare të ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2008, më është shtuar pasiguria për kursimet dhe, për këtë arsye, kam tërhequr kursimet që ndodheshin në bankë, duke i ruajtur cash në shtëpi.*

Në deklaratën përpara fillimit të detyrës kam deklaruar kursime cash në shumën 800,000 lekë. Pasi kam filluar detyrën e gjyqtarit këto kursime janë shpenzuar. Në fund të vitit 2008, nga tri shumatat e tërhequra gjatë vitit 2008: (i) 350,000 lekë në datën 13.10.2008; (ii) 300,000 lekë në datën 6.11.2008; (iii) 500,000 lekë në datë 30.12.2008, kam pasur gjendje në banesë shumën 1,050,000, lekë ose 250,000 lekë më shumë se shuma e deklaruar para fillimit të detyrës.

Në DPV-në e vitit 2008 kam deklaruar “para cash nga llogaria rrjedhëse në shtëpi” duke dashur të theksoj se kursimet që kisha realizuar nga të ardhurat e mia (investuar madje edhe në depozita kursimi, në vitet 2006 - gjysmën e parë të vitit 2008) i kam tërhequr duke i mbajtur gjendje cash në shtëpi.

Në DPV-në e vitit 2008, tek kolona ku shënohen shtesat kam vendosur vetëm shumën 250,000 lekë, sepse pjesa tjetër 800,000 lekë ka zëvendësuar gjendjen cash të deklaruar para fillimit të detyrës. Gjithashtu në datë 31.12.2008 gjendja bankare e llogarisë rrjedhëse ka qenë në shumën 521,350 lekë, sigurisht me burim të ardhurat nga paga.

Gjatë vitit 2009 nga kursimet e akumuluar në llogarinë rrjedhëse janë tërhequr edhe dy shuma të tjera në vlerën 900,000 lekë (500,000 lekë në datën 11.3.2009 dhe 400,000 lekë në datë 18.8.2009). Këto shuma i janë shtuar kursimeve cash në fund të vitit 2008 dhe e gjithë vlera e kursyer në cash 1,950,000 lekë (1,050,000 lekë në fund të vitit 2008 + 900,000 lekë të tërhequra nga llogaria rrjedhëse në vitin 2009) është konvertuar në euro (në momente kur kursi i këmbimit ka qenë më i favorshëm) dhe ka shërbyer për pagesën e apartamentit në datën 5.1.2010.

Pranoj faktin që nuk kam deklaruar shtesën e gjendjes cash në DPV-në e vitit 2009, por duke qenë se e gjithë shuma e kursyer cash është zeruar (0) në datën 5.1.2010, pra vetëm pesë ditë nga data 31.12.2009 dhe tre muaj përpara se të deklarohej DPV-ja e vitit 2009. Pakësimin e gjendjes cash në DPV-në e vitit 2010 e kam konsideruar të deklaruar për shkak se kam theksuar se për pagesën e çmimit të apartamentit janë përdorur kursimet nga pagat. Është e kuptueshme që në datën 5.1.2010 nuk mund të kisha kursime të tjera nga paga, përveç atyre të akumuluar deri në datën 31.12.2009.

Gjithashtu, në datën 4.12.2014 kam dhënë shpjegime në ILDKPKI duke theksuar se: “Burimi i blerjes së këtij apartamenti është huamarrja e deklaruar nga ana ime në shumën 24,000 euro, pakësimi i gjendjes cash dhe depozitave të deklaruara nga ana ime”. Nga statement bankar lexohen qartësisht tërheqjet për shpenzimet jetike dhe kursimi i pjesës së mbetur. Fillimisht, kursimet e akumuluar gjatë një periudhe të caktuar janë investuar në depozita pastaj për shkak të krizës së sistemit bankar, depozitat dhe kursimet që akumuloheshin i kam tërhequr dhe ruajtur në banesë me qëllimin e vetëm sigurimit të një banese për jetesë me familjen time të ardhshme.

Të dhënat që burojnë nga këqyrja e statmentit bankar të analizuara së bashku me të dhënat që burojnë nga dokumentet e tjera bashkëlidhur deklaratës Vetting, por edhe me rrethanat

¹⁷ Shihni përgjigjen e bashkëshortes së subjektit në dosjen përkatëse.

jetësore, tregojnë se kursimet nga pagat, në vlerën 1,950,000, të akumuluar cash deri në fund të vitit 2009, kanë shërbyer si një nga burimet për pagesën e çmimit të apartamentit në datën 5.1.2010.

Pasaktësia në DPV-në vjetore të vitit 2009 dhe paplotësia në DVP-të e viteve 2008 dhe 2009 është ndrequr jashtë procesit të rivlerësimit, në shpjegimet që kam dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin e datës 4.12.2014, pyetje të shtruara nga inspektorja e ILDKPKI-së në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003.

Mendoj se ky procesverbal i hartuar dhe i mbështetur në një dispozitë ligjore nga organi kompetent është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka unifikuar qëndrimin se pasaktësitë e ndrequra jashtë procesit të rivlerësimit nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore”.

1.58 Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së më 4.12.2014, subjekti ka deklaruar: “Burimi i blerjes së këtij apartamenti është huamarrja e deklaruar nga ana ime në shumën 24,000 euro, pakësim i gjendjes cash dhe depozitave të deklaruara nga ana ime. Po ju paraqes edhe kryerjen e derdhjes së kësaj shume në favor të firmës ndërtuese kryer nëpërmjet Intesa Sanpaolo Bank më 5.1.2010. Gjithashtu, shikoni edhe përgjigjet e Raiffeisen Bank, ku konfirmohet që depozitat e deklaruara pranë kësaj banke janë tërhequr në vitin 2009”.

1.59 Nga statement-i bankar, sjellë nga Raiffeisen Bank¹⁸, rezulton në emër të subjektit një llogari rrjedhëse në monedhën lekë, me nr. ***, si dhe ka pasur depozita në monedhën lekë në vitet 2006 – 2008.

1.60 Depozita e parë në vlerën 300,000 lekë është krijuar duke transferuar këtë vlerë nga llogaria rrjedhëse e pagës në emër të subjektit në datën 29.12.2006. Nga rezultati financiar pozitiv i periudhës 5.10.2006 – 31.12.2006¹⁹ rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite. Kjo depozitë maturohet në datën 29.12.2007 dhe bashkë me të ardhurat nga paga, që ishin gjendje në llogari, krijojnë depozitën e datës 31.12.2007 në vlerën 400,000 lekë, të trajtuar në pikën 1.63.

1.61 Depozita tjetër në vlerën 400,000 lekë është krijuar duke transferuar këtë vlerë nga llogaria rrjedhëse e pagës në emër të subjektit në datën 17.12.2007. Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të kësaj depozite si më poshtë:

Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës 400,000 lekë në datën 17.12.2007

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2007 – 17.12.2007	741,115
Të ardhura totale 1.1.2007 – 17.12.2007	741,115
Shpenzime jetese 1.1.2007 – 17.12.2007	130,928
Shpenzime qiraje 1.1.2007 – 17.12.2007	33,000
Shpenzime totale 1.1.2007 – 17.12.2007	163,928
Ndryshim likuiditeti 31.12.2006 – 17.12.2007	419,913
Mundësia financiare	157,275

1.62 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës. Kjo depozitë maturohet në datën 17.12.2008.

1.63 Depozita tjetër në vlerën 400,000 lekë është krijuar duke transferuar këtë vlerë nga llogaria rrjedhëse e pagës në emër të subjektit në datën 31.12.2007. Nga rezultati financiar

¹⁸ Shihni përgjigjen e Raiffeisen Bank në shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2019, në dosjen e bashkëshortes së subjektit.

¹⁹ Shihni analizën financiare në pikën 10 të këtij vendimi.

pozitiv i vitit 2007²⁰ subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite. Kjo depozitë maturohet në datën 31.12.2008.

1.64 Depozita tjetër në vlerën 300,000 lekë është krijuar duke transferuar këtë vlerë nga llogaria rrjedhëse e pagës në emër të subjektit në datën 5.5.2008. Komisioni analizoi mundësinë e krijimit të kësaj depozite si më poshtë:

Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës 300,000 lekë, në datë 5.5.2008

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2008. – 5.5.2008	352,800
Të ardhura totale 1.1.2008 – 5.5.2008	352,800
Shpenzime jetese 1.1.2008 – 5.5.2008	45,540
Shpenzime qiraje 1.1.2008 – 5.5.2008	12,000
Shpenzime totale 1.1.2008 – 5.5.2008	57,540
Ndryshim likuiditeti 31.12.2007 – 5.5.2008	270,329
Mundësia financiare	24,931

1.65 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës. Kjo depozitë maturohet në datën 17.12.2008.

1.66 Të ardhurat nga interesat e këtyre depozitave janë konsideruar si të ardhura të ligjshme në analizën financiare.

1.67 Nga analizimi i bërë më sipër në pikat 1.60 - 1.64, subjekti kishte mundësi për krijimin e depozitave në periudhën 2006 – 2008.

1.68 Nga lëvizjet bankare në këtë llogari rezulton se në vitin 2008, subjekti ka bërë tërheqje nga llogaria: (a) 350,000 lekë në datën 31.10.2008; (b) 300,000 lekë në datën 6.11.2008 dhe 500,000 lekë në datën 30.12.2008. Në total, tërheqjet për vitin 2008 arrijnë vlerën 1,150,000 lekë (pa përfshirë tërheqjet e bëra në vlera të vogla).

1.69 Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: “*Para cash nga llogaria rrjedhëse në shtëpi, nga paga si gjyqtar - 250,000 lekë – 100% pjesë takuese*”. Pra, në këtë vit, subjekti ka deklaruar se sa kursime shtesë *cash* ka shtuar në krahasim me deklarin e vitit të mëparshëm duke konsideruar si burim për këtë shtesë tërheqjet e bëra nga banka.

1.70 Nga lëvizjet bankare në këtë llogari rezulton se në vitin 2009 subjekti ka bërë tërheqje nga llogaria (a) 500,000 lekë në datën 11.3.2009; (b) 400,000 lekë në datën 18.8.2009. Në total, tërheqjet për vitin 2009 arrijnë vlerën 900,000 lekë (pa përfshirë tërheqjet e bëra në vlera të vogla).

1.71 Në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk deklaroi as shtim të kursimeve *cash* dhe as pakësim të llogarive bankare.

1.72 Sipas deklarin të subjektit në deklaratat periodike vjetore, gjendja progresive e kursimeve *cash* në fund të vitit 2009 ishte në vlerën 1,050,000 lekë (800,000 lekë para fillimit të detyrës në vitin 2006 dhe 250,000 lekë shtesë në vitin 2008). Subjekti pretendoi se në fund të vitit 2009 ai kishte një gjendje progresive të kursimeve *cash* në shumën 1,950,000 lekë, duke përfshirë edhe vlerën e tërhequr nga banka në vitin 2009. Komisioni e mori në konsideratë këtë shtesë kursimesh *cash* në vlerën 900,000 lekë, nisur nga periudha e shkurtër mes fundit të vitit 2009 dhe datës së kryerjes së pagesës (5.1.2010), burimit të ligjshëm të krijimit të këtyre likuiditeteve bankare të analizuara më sipër, si dhe ndreqjen e kësaj pasaktësie përpara deklaratës *Vetting* (referuar procesverbalit të datës 4.12.2014, përpara ILDKPKI-së).

²⁰ Shihni analizën financiare në pikën 10 të këtij vendimi.

1.73 Lidhur me mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* ndër vite, Komisioni analizoi mundësinë e subjektit për krijimin e tyre para fillimit të detyrës në shumën 800,000 lekë, si dhe shtesën prej 250,000 lekësh në vitin 2008.

1.74 I pyetur për burimin e krijimit të kursimeve *cash* në shumën 800,000 lekë para fillimit të detyrës, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, deklaroi se: “*Burim i krijimit të kursimeve cash të deklaruar në deklaratën time para fillimit të detyrës janë:*

- i. të ardhurat nga puna pranë Q.Sh.D.Nj, pozicioni asistent koordinator në periudhën korrik – shtator 2004, në vlerën neto 750 euro sipas vërtetimit bashkëlidhur deklaratës Vetting;*
- ii. të ardhurat nga bursa në Shkollën e Magjistraturës në vlerën neto 936,090 lekë;*
- iii. të ardhurat nga dieta e K.E afro 650 euro për udhëtimin e kryer gjatë studimit në Shkollën e Magjistraturës në Lisbonë, Portugali.*

Përpara se të punësohesha në Q.Sh.D.Nj kam punuar si konsulent juridik në mënyrë të pavarur, ku kam siguruar të ardhura simbolike, por domethënëse për kohën, por që për shkak të kohës së gjatë dhe informalitetit nuk kam mundur të siguroj dokumente për të dokumentuar këto të ardhura.

Gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës për vitet 2004 – 2006 kam përfituar bursë në shumën 936,090 lekë.

*Gjithashtu, gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës, në vitin e dytë të studimeve disa studentë të këtij viti dhe pedagogë të shkollës, kemi shkuar për një vizitë studimore pranë Shkollës së Magjistraturës në Lisbonë, Portugali. Organizatorët përveçse kanë mbuluar të gjitha shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe akomodimit, kanë akorduar dieta për secilin pjesëmarrës në shumën afro 650 euro. Për këtë shumë nuk disponoj mandat përkatës, pasi e gjitha shuma e parave për të gjithë pjesëmarrësit është disponuar nga njëri prej përfaqësuesve të shkollës, i cili më pas ka bërë shpërndarjen e tyre. Fakti i kësaj vizite provohet nga viza studimore dhe vulat e ndodhura në pasaportë kopje të së cilës ua kam vënë në dispozicion me pyetësorin nr. ***.*

Në vitin 2006, në llogarinë time në Raiffeisen Bank më është kredituar paga si gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në shumën 55,971 lekë”.

1.75 Në përgjigjen e tij, subjekti solli edhe një analizë të mundësisë së tij për kursimin e kësaj shume, duke mos përfshirë këtu shpenzimet e veta të jetesës, me pretendimin se ato janë mbuluar nga familja prindërore për periudhën tetor 2004 – tetor 2006 (gjatë kohës që ka qenë në Shkollën e Magjistraturës).

1.76 Nga ana tjetër, ai në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka paraqitur një analizë të mundësisë së familjes prindërore për dhënien e huas prej 12,000 euro subjektit. Këtu, ai deklaroi: “*Analizën financiare e kam kryer për vitet 2005 – 2009, periudhë gjatë së cilës nuk kam jetuar me prindërit (pra, periudhën pasi fillova Shkollën e Magjistraturës)*”. Në këtë analizë financiare ai nuk e përfshin veten në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës.

1.77 Sa më sipër, Komisioni, në analizën financiare të mundësisë së kursimit të shumës 800,000 lekë para fillimit të detyrës, ka konsideruar se subjekti i ka mbuluar vetë shpenzimet e jetesës gjatë periudhës së Shkollës së Magjistraturës e në vijim.

1.78 Gjithashtu, nga burimet e pretenduara nga subjekti për krijimin e kursimeve në vlerën 800,000 lekë para fillimit të detyrës, ishin edhe të ardhurat nga “Q.Sh.D.Nj”. Për të vërtetuar këto të ardhura, subjekti ka sjellë një vërtetim të lëshuar nga kjo qendër, sipas të cilit, nga angazhimi i subjektit si asistent koordinator për 3 muaj kishte marrë një pagë mujore prej 250 euro. Sipas përgjigjes që vjen nga Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH-së²¹, për periudhën

²¹ Shihni përgjigjen e ISSH-së tek hetimi i bashkëshortes në shkresën nr. *** prot., datë 14.6.2019.

korrik 2004 – shtator 2004, pranë subjektit “Q.Sh.D.Nj”, me NIPT *** dhe nr. dosje *** juridik, emri i subjektit nuk figuron në listëpagesa.

1.79 Deri në mbyllje të rezultateve të hetimit nuk u vërtetua pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga subjekti pranë Q.Sh.D.Nj, prandaj Komisioni nuk i konsideroi si burim të ligjshëm këto të ardhurat e pretenduara nga subjekti në shumën 750 euro.

Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve *cash* 800,000 lekë para detyre

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga bursa subjekti tetor 2004 – 4.10.2006	936,090
Të ardhura totale tetor 2004 – 4.10.2006	936,090
Shpenzime jetese tetor 2004 – 4.10.2006	215,216
Gjendje në llogari page RFZ subjekti 4.10.2006	265,559
Gjendje <i>cash</i> - 4.10.2006	800,000
Pamundësia financiare	-344,684
Mundësia reale për kursim <i>cash</i>	455,316

1.80 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti deri në datën e fillimit të detyrës (4.10.2006) kishte mundësi të kursente vetëm shumën 455,316 lekë *cash* e 265,559 lekë në llogari bankare, si dhe të mbulonte shpenzimet e jetesës për periudhën.

1.81 Sa më sipër, vetëm vlera prej 455,316 lekësh u konsiderua si burim i ligjshëm nga kursimet e vitit 2006 për blerjen e apartamentit në vitin 2010.

1.82 Lidhur me mundësinë e shtimit të kursimeve *cash* në vitin 2008 (shtesë 250,000 lekë), duke iu referuar analizës financiare²², për shkak të rezultatit pozitiv të vitit 2008, subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e këtyre kursimeve në shumën e deklaruar. Prandaj kjo vlerë prej 250,000 lekësh, e shtuar në kursimet *cash* në vitin 2008, u konsiderua si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2010.

1.83 Në total, duke marrë parasysh edhe shtimin e kursimeve *cash* në vitin 2009 nga depozitat dhe pagat, pjesa e kursimeve të konsideruara si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit në vitin 2010, arrin vlerën 1,605,316 lekë (455,316 + 250,000 + 900,000 lekë).

1.84 Sa më sipër, pasi u analizua mundësia e kursimit nga subjekti dhe mundësia e huadhënësve për huat e deklaruar, Komisioni hartoi një analizë të mundësisë së subjektit për pagesën e vlerës 38,260 euro (5,270,000 lekë) për blerjen e apartamentit në datën 5.1.2010 si më poshtë në të dyja mundësitë e llogaritjes së kursimeve *cash*:

1.85 Nga analiza financiare, Komisionit i rezultoi se subjekti kishte pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e apartamentit në datën 5.1.2010 në vlerën -1,361,037 lekë. Në këtë analizë financiare nuk është konsideruar si burim për huadhënien vlera e të ardhurave të përfituara nga huadhënësja E.D përmes bankës nga *** për periudhën 2008 – 2009.

1.86 Në përfundim të hetimit, në lidhje me blerjen e pasurisë apartament në vitin 2010, Komisioni arriti në konkluzionet se:

- Ka mospërputhje të vlerës së blerjes së apartamentit midis deklaramentit në deklaratën *Vetting* të subjektit të rivlerësimit (vlera 32,260 euro) me kontratat dhe deklaratat periodike vjetore të tij në vitet 2010 dhe 2011 (vlera 38,260 euro) lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit. Por për Komisionin kjo konsiderohet një lapsus dhe vlera e përlllogaritur për blerjen e kësaj pasurie dhe e provuar është vlerësuar në analizën financiare në shumën 38,260 euro.

²² Shihni analizën financiare në pikën 10 të këtij vendimi.

- Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë për gjendjen e kursimeve *cash* në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, duke mos deklaruar shtimin e gjendjes *cash* nga tërheqja e likuiditeteve bankare në këtë vit.

Ndërsa nga analiza financiare, rezultoi se:

- Huadhënësi B.K, babai i subjektit të rivlerësimit, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë huan në shumën 12,000 euro.
- Huadhënësja/shtetasja E.D nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për ligjshmërinë e të ardhurave totale të shumës prej 12,000 euro, dhënë hua subjektit të rivlerësimit (pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për një pjesë të të ardhurave të përfituara me bankë).
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e apartamentit, duke rezultuar me një pamjaftueshmëri në vlerën (-1,361,037).

1.87 Për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime apo prova të tjera.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.88 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka prapësuar duke shpjeguar se: *“...Pranoj faktin që nuk kam deklaruar në DPV-në e vitit 2009 kalimin e likuiditetit nga llogaria bankare në shtëpi, por të gjitha kursimet e akumuluar cash janë zeruar në datën 5.1.2010, pra vetëm pesë ditë nga data 31.12.2009. Pakësimin e gjendjes cash në DPV-në e vitit 2010 e kam konsideruar të deklaruar për shkak se kam theksuar se për pagesën e çmimit të apartamentit janë përdorur kursimet dhe huamarrjet; ashtu siç kam deklaruar edhe në deklaratën Vetting si burim të krijimit kursimet nga paga dhe huamarrjet, qëndrim tashmë i konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²³. Gjithashtu, në datën 4.12.2014 kam dhënë shpjegime në ILDKPKI, duke theksuar se: “Burimi i blerjes së këtij apartamenti është huamarrja e deklaruar nga ana ime në shumën 24,000 euro, pakësimi i gjendjes cash dhe depozitave të deklaruara nga ana ime”. Të dhënat që burojnë nga këqyrja e statement-it bankar të analizuar së bashku me të dhënat që burojnë nga dokumentet e tjera bashkëlidhur deklaratës Vetting, por edhe me rrethanat jetësore²⁴ tregojnë se kursimet nga pagat në vlerën 1,950,000, të akumuluar cash deri në fund të vitit 2009, kanë shërbyer si një nga burimet për pagesën e çmimit të apartamentit në datën 5.1.2010. Deklarimi i gjendjes cash në vlerën 900,000 lekë (500,000 lekë në datën 11.3.2009 dhe 400,000 lekë në datën 18.8.2009), të cilat kanë qenë gjendje në banesë në fund të vitit 2009 është kryer jashtë procesit të rivlerësimit, në shpjegimet që kam dhënë në përgjigje të pyetjeve të pasqyruara në procesverbalin e datës 4.12.2014, pyetje të shtruara nga inspektorja e ILDKPKI-së në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003. Ky procesverbal i hartuar, mbështetur bazuar në një dispozitë ligjore nga organi kompetent, është një dokument zyrtar në kuptim të nenit 49, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka unifikuar qëndrimin²⁵ se pasaktësitë e ndrequra jashtë procesit të rivlerësimit nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.*

*Është paraqitur dokumentacion justifikues ligjor i shtetas E.D për të vërtetuar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për dhënie e huas nga znj. E.D, e cila ka qenë e punësuar pranë OJF-së “P.A” dhe ka pasur kontrata shërbimi me *** Shqipëri. Të ardhurat neto të realizuara, pjesa më e madhe e të cilave kanë kaluar në llogari bankare në vitet 2005 – 2009 janë në shumën rreth 3,000,000 lekë, shumë e konsideruar më se e mjaftueshme për të justifikuar huan. Sipas vërtetimit të sjellë nga P.A.Ch.D, vërtetohen të ardhura neto totale për*

²³ Vendimi nr. 33/2021 (JR), datë 3.11.2021; vendimi nr. 2/2022, datë 15.2.2022, vendimi nr. 28, datë 14.7.2022 etj.

²⁴ Leximi në tërësi i të dhënave që burojnë nga *statement*-i bankar tregon qartë jetesën time të thjeshtë dhe dëshirën/tendencën për të kursyer me qëllim krijimin e familjes së re të ardhshme.

²⁵ Në vendimin nr. 20, datë 14.6.2022, të Kolegjit.

periudhën gusht 2005 – nëntor 2008, në shumën 1,241,567 lekë. Ndërkohë, nga librezat e kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor vërtetohen të ardhura neto totale për periudhën Gusht 2005-Korrik 2008, në shumën 1,021,568 lekë. Sipas një statement-i të llogarisë bankare (të Intesa Sanpaolo Bank) vërtetohet se në emër të shtetases E.D për periudhën gusht 2008 – nëntor 2008 ka kaluar paga në fund të çdo muaji, total shuma 207,000 lekë.

Komisioni ka konsideruar si të ardhura të ligjshme pagat e vërtetuara nga vërtetimi i lëshuar nga “P.A.Ch.D”, të cilat konfirmohen dhe në librezën e kontributeve për sigurim shoqëror dhe shëndetësor (gusht 2005 – korrik 2008) në vlerën 1,021,568 lekë (e barasvlefshme me 8,348 euro). Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, detyrimi për mbajtjen dhe pagimin e detyrimeve tatimore (sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP e ka punëdhënësi i ngarkuar nga ligji²⁶ si agjent i mbajtjes së tatimit në burim).

Huadhënësja E.D ka pasur kontrata shërbimi edhe me *** Shqipëri që nga nëntori 2008 e në vazhdim, ku vërtetohet se në llogarinë bankare në emër të shtetases E.D tek Intesa Sanpaolo Bank për periudhën dhjetor 2008 – dhjetor 2009 ka kaluar në total shuma 1,926,130 lekë. Pavarësisht se kontratat e shërbimit të lidhura mes *** dhe shtetases E.D, përcaktojnë se për “Tatimin mbi të ardhurat”, punëmarrësi është vetë përgjegjës për të gjitha taksat dhe *** nuk do të bëjë asnjë ndalesë për qëllime të pagesës së tatimit mbi të ardhurat, ky parashikim në kontratë bie ndesh me legjislacionin tatimor të kohës, kur agjenti tatimor ka qenë punëdhënësi dhe, për këtë arsye, është i pavlefshëm. *** rezulton të ketë qenë i regjistruar në organet tatimore që në vitin 1996 me numër unik identifikimi. Nisur nga mënyra se si rregullohej situata ligjore në kohën e punësimit të kësaj shtetaseje pranë *** ka qenë detyrim i administratës së këtij të fundit që të mbante tatimin në lidhje me këtë shtetase, pasi kjo e fundit nuk ka pasur mjet ligjor se si të bënte derdhjen përkatëse, pa pasur një kod identifikimi. E vetmja mënyrë që të realizohej jashtë sferës së veprimtimit të punëdhënësit është përmes deklaratës individuale të të ardhurave. Deklarata individuale e të ardhurave, si koncept ka hyrë në fuqi me ligjin nr. 20/2012, botuar në Fletore Zyrtare më 27.3.2012 dhe ka vlerë vetëm për detyrimet nga të ardhurat e realizuara në vitin 2011 e në vijim. Pra, ligjvënësi nëpërmjet ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Ministria e Financave përmes vullnetit të shpallur në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, kanë përcaktuar si agjent tatimor punëdhënësin. Në kushtet kur shtetases E.D paga i ka kaluar me bankë bazuar edhe në jurisprudencën e sipërcituar të Kolegjit kjo e ardhur duhet të ishte konsideruar si e ardhur e ligjshme.

Jo vetëm E.D, por edhe prindërit e saj (daja im H.D dhe bashkëshortja e tij D.D) kanë pasur të ardhura të konsiderueshme si rezultat i punësimit të tyre. Bashkëlidhur prapësimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion²⁷ për të ardhurat e realizuara nga ana e tyre.

²⁶ Subjekti citon pjesë nga përmbajtja e vendimit nr. 35/2022 të Kolegjit.

²⁷ Shihni dokumentacionin bashkëlidhur prapësimeve të subjektit: vërtetime të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shkodër datës 29.2.2024 “Për pagën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare” të shtetases D.D në ndërmarrjen “U.P”, që prej vitit 1994 – 2011 (tri fletë); vërtetim “Për vjetërsinë në shërbim dhe pagën mesatare neto referuese” viti 2011 lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore mbi punësimin e shtetasit H.D nga viti 1978 deri në vitin 1994 (një fletë); vërtetim i lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, dega e përfitimeve Shkodër, i cili vërteton përfitimin e shtetasit H.R.D me pension të parakohshëm për periudhën 1.7.2009 – 15.7.2019 (një fletë); vërtetimi “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare” e të Agjencisë së Trajtitimit të Kredive për Punësimin e shtetasit H.D periudhën 2002 – 2007 (një fletë); fletë regjistri themeltar të punonjësit – Bashkia Pukë që i përket shtetasit H.D (një fletë); vërtetim i datës 7.11.2019 i lëshuar nga Bashkia Pukë për punësimin e shtetasit H.D, duke filluar që prej vitit 1977 deri në vitin 2019 (një fletë); vërtetim “Për bazën e vlerësuar” lëshuar nga ISSH-ja të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër mbi punësimin e shtetasit H.D pranë Ujësjetës Pukë (një fletë); vendim për caktim pensioni nr. *** datë 20.11.2019, si dhe fletë përlllogaritjeje për periudhën e sigurimit (dy fletë); librezat e sigurimeve shoqërore për shtetasin A.D (dy fletë), ku pasqyrohet fakti i punësimit të tij për vitin 2009 pranë KQZ-së dhe shoqërisë “***” sh.p.k.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur rezulton se shtetasja E.D ka pasur mundësi financiare të mbulojë me burime të ligjshme financiare huan në shumën 12,000 euro, prandaj në analizën financiare duhet të përfshihet e gjithë shuma e marrë hua nga kjo shtetase.

Nga analiza financiare rezulton se gjendja ime cash në fund të vitit 2009 ka qenë në vlerën 1,950,000 lekë, por Komisioni nga kjo gjendje zbrit vlerën e pamundësisë financiare para detyrës.

Në lidhje me diferencën e konstatuar përpara fillimit të detyrës, deklaroj ashtu siç kam theksuar edhe gjatë hetimit administrativ se në muajt korrik – shtator 2004 kam përfutuar të ardhura nga puna pranë Q.Sh.D.Nj, pozicioni asistent koordinator, në vlerën neto 750 euro, sipas vërtetimit bashkëlidhur deklaratës Vetting.

Bazuar në jurisprudencën e Konsoliduar të Kolegjit, por edhe bazuar në analizën ligjore të sipërcituar ka qenë detyrim i Q.Sh.D.Nj pagesa e detyrimeve tatimore. Në këtë kohë unë sapo kisha mbaruar studimet dhe kam qenë në mirëbesim se punëdhënësi i përmbushte të gjitha detyrimet tatimore, duke besuar që ai i ka paguar detyrimet tatimore. Kjo e ardhur duhet të përfshihet në analizën financiare duke përfshirë edhe shpenzimet jetike për periudhën korrik – shtator 2004. Në këto kushte, pamundësia financiare para fillimit të detyrës është në shumën 273,120 lekë dhe duke përdorur logjikën e Komisionit në analizën financiare për blerjen e apartamentit duhet të përfshihet gjendja cash në $1,950,000 - 273,120 = 1,676,880$ lekë.

Pamundësia financiare në datën 5.1.2010 është në -285,920 lekë, diferencë e cila shkaktohet vetëm për shkak të diferencës negative të konstatuar përpara fillimit të detyrës (diferenca konstatuar në datën 5.1.2010 është pothuajse e barabartë me diferencën e konstatuar përpara fillimit të detyrës).

Gjithashtu, Komisioni duhet të mbajë në vlerësim edhe faktin që në vitin 2008 unë kam tërhequr nga kursimet në llogari bankare shumën 1,150,000 lekë. Në analizën financiare të vitit 2008 Komisioni përllogarit si shpenzim një zë “Shpenzimet nga tërheqjet bankare” në vlerën 710,000 lekë, shpenzim i cili nuk është realizuar nga ana ime. Nga statement-i bankar rezulton se tërheqjet në vlerën 1,150,000 lekë janë kryer në periudhën tetor 2008 – dhjetor 2008 dhe njëra nga shumat në vlerën 500,000 lekë është tërhequr në datën 30.12.2008, kështu që ka qenë e pamundur që në datën 31.12.2008 kjo shumë të ishte harxhuar duke pasur në vlerësim edhe stilin tim të jetesës”.

Vlerësimi i Komisionit

1.89 Komisioni mori në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti lidhur me të ardhurat nga pagat e pensionit të parakohshëm të babait të huadhënësës E.D .

1.90 Për këtë Komisioni hartoi analizën financiare duke përfshirë të ardhurat e ligjshme të huadhënësës dhe familjarëve të saj, bazuar në dokumentacionin provues të paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

Analiza e mundësisë së huadhënies nga E.D gusht 2005 – dhjetor 2009

Përshkrimi	Vlera
Paga gusht 2005 – dhjetor 2009 nëna D.D	1,887,863
Paga gusht 2005 – dhjetor 2009 babai H.D	1,678,353
Pension i parakohshëm korrik – dhjetor 2009 babai H.D	177,054
Paga gusht 2005 – dhjetor 2009 E.D	1,043,337
Paga gusht 2005 – dhjetor 2009 vëllai A.D	326,204
Të ardhura totale gusht 2005 – dhjetor 2009 familja D	5,112,810
Shpenzime jetese 5 persona gusht 2005 – dhjetor 2009	2,825,329
Hua Bezart Kaçkinit - 12,000 euro	1,653,600
Mundësia financiare	633,882

Nga analiza financiare rezulton se znj. E.D dhe familjarët e saj kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për gjithë anëtarët e saj, si dhe për krijimin e shumës së dhënë hua subjektit në janar të vitit 2010. Në këtë analizë financiare nuk u përfshinë të ardhurat e huadhënësës që ka pasur me *** për periudhën dhjetor 2008 – dhjetor 2009, pasi për këto të ardhura nuk u vërtetuan pagimet e detyrimeve tatimore.

1.91 Pas rillogaritjes së këtyre të ardhurave të personit tjetër të lidhur, Komisioni arriti në konkluzionin se znj. E.D kishte mundësi t'i jepte hua shumën 12,000 euro subjektit në janar 2010 për blerje apartamenti në Y, Tiranë.

1.92 Lidhur me kursimet *cash*, Komisioni arriti në përfundimit se pavarësisht faktit se subjekti nuk kishte mundësi për krijimin e vlerës së kursimeve *cash* në shumën 800,000 lekë²⁸, këto kursime janë shpenzuar në vitin 2008. Kurse kursimet *cash* (si gjendje në fund të vitit 2008) rezultoi se e kanë burimin nga tërheqjet e depozitave bankare të bërë po këtë vit, në vlerën 1,150,000 lekë. Vlera totale e tërheqjeve është e mjaftueshme për krijimin e gjithë gjendjes *cash* prej 1,050,000 lekësh në vitin 2008. Sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se shpjegimet e subjektit lidhur me ligjshmërinë e gjendjes *cash* në fund vitin 2008 në shumën 1,050,000 lekë ishin të mjaftueshme.

1.93 Sa më sipër, gjendja e kursimeve *cash* në shumën 1,050,000 lekë në fund të vitit 2008 është konsideruar nga Komisioni si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit në vitin 2010.

1.94 Lidhur me mosdeklarimin e shtimit të kursimeve *cash* në vlerën 900,000 lekë, në vitin 2009, nga tërheqjet bankare Komisioni i qëndroi vlerësimin paraprak të tij në rezultatet e hetimit. Bazuar në faktin se: (a) kjo çështje është sqaruar në ILDKPKI, jashtë dhe pavarësisht procesit të rivlerësimit të pasurisë; (b) koha ndërmjet fundvitit 2009 dhe shpenzimit të këtyre kursimeve për blerjen e apartamentit në janar të vitit 2010 ka qenë shumë e shkurtër; (c) vërtetimit të burimit të ligjshëm të krijimit të këtyre likuiditeteve bankare të tërhequra nga subjekti, kjo shtesë e kursimeve *cash* është konsideruar si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit në vitin 2009.

1.95 Nga analiza e bërë, mundësia e krijimit të kursimeve *cash* nga subjekti në fund të vitit 2009 rezultoi të jetë në total në vlerën 1,950,000 (800,000 + 250,000 + 900,000).

1.96 Në këto kushte, Komisioni hartoi edhe një herë analizën e mundësisë së blerjes së apartamentit nga ana e subjektit sipas tabelës më poshtë.

Analiza e mundësisë së blerjes së apartamentit – 5.1.2010

Përshkrimi	Vlera
Kursime <i>cash</i> subjekti 2006 – 4.1.2010	1,950,000
Të ardhura nga pagat subjekti 1.1.2010 – 4.1.2010	0
Hua nga babai i subjektit - 12,000 euro	1,653,600
Hua nga E. D. - 12,000 euro	1,653,600
Totali i burimeve	5,257,200
Blerje apartamenti - 38,260 euro	5,270,000
Pamundësia financiare	-12,800

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka një pamundësi financiare prej -12,800 lekësh për blerjen e apartamentit në datën 5.1.2010.

²⁸ Shihni analizën financiare për periudhën para fillimit të detyrës.

1.97 Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi faktet dhe dokumentacionin e dërguar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, në harmoni me ato të administruara gjatë hetimit, arriti në përfundimin se subjekti ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm në lidhje me krijimin e pasurisë apartament në vitin 2010, nga ku i rezultoi një pamjaftueshmëri financiare në shumën -12,800 lekë, vlerë e cila është e pakonsiderueshme për të ndikuar në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

2. Llogari rrjedhëse pranë Bankës Kombëtare Tregtare

2.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon gjendje në llogarinë rrjedhëse nr. *** pranë Bankës Kombëtare Tregtare, si dhe kartë krediti me gjendje debie 0 (zero) lekë me limit 85,000 lekë. Vlera: 1,136,101 lekë. Zotërimi: 100%.

2.2 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer kursimet nga paga të akumuluar në vite.

2.3 Nga hetimi i Komisionit, Banka Kombëtare Tregtare²⁹ konfirmon se subjekti Bezart Kaçkini disponon llogari rrjedhëse me gjendje në lekë në shumën 1,136,101 lekë, në datën 26.1.2017.

2.4 Komisioni konstatoi se gjendja e kësaj llogarie është akumuluar duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim, si llogari ku ka kaluar paga e subjektit nga marrëdhëniet e punës.

2.5 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për krijimin e këtij likuiditeti bankar³⁰ për këtë periudhë.

2.6 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë gjendje llogarie bankare.

3. Llogari inaktive pranë Tirana Bank, me nr. ***

3.1 Rezultoi se sipas përgjigjes nga Tirana Bank, në shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, subjekti Bezart B.K ka llogari në Tirana Bank, në lekë, çelur në vitin 2010. Sipas *statement-it* bankar të kësaj llogarie, gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën -608,11 lekë.

3.2 Komisioni konstatoi se gjendja e kësaj llogarie është akumuluar duke filluar nga viti 2010 deri në vitin 2015, si llogari ku ka kaluar paga e subjektit nga marrëdhëniet e punës. Më pas nuk ka shtesa të tjera në llogari, por debitohen vetëm komisionet bankare.

3.3 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për krijimin e këtij likuiditeti bankar³¹ për këtë periudhë.

3.4 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë gjendje llogarie bankare.

4. Të ardhurat

4.1 Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhurat si më poshtë:

- të ardhura nga puna pranë Q.Sh.D.Nj, pozicioni asistent koordinator, në periudhën korrik – shtator 2004, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 750 euro;

²⁹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2021, në dosjen e subjektit dhe shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2019, në dosjen e bashkëshortes së subjektit.

³⁰ Shihni analizën financiare më poshtë në pikën 10 të këtij vendimi.

³¹ Shihni analizën financiare më poshtë në pikën 10 të këtij vendimi.

- të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, në periudhën 2004 – 2006 bursë, si dhe pagesa si lehtësues/lektor në periudhën 2015 – 2016, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 965,310 lekë;
- të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, periudha tetor 2006 – nëntor 2007, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 904,368 lekë;
- të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, periudha nëntor 2007 – mars 2010, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 2.635.849 lekë;
- të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, periudha prill 2010 – tetor 2013, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 3,490,817 lekë;
- të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, periudha nëntor 2013 e në vazhdim, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 3,296,042 lekë;
- të ardhura nga puna si pedagog pranë universitetit “****”, Shkodër (shoqëria “****” sh.p.k.), bashkëlidhur vërtetimi, shuma 217,663 lekë;
- të ardhura (dieta) nga *** (Ambasada e SHBA-së, Tiranë) në kuadër të programit, I.V.L, periudha korrik – gusht 2011, shuma 1.400 USD.

4.2 Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhurat:

- të ardhura nga puna në SHBA, Florida, gjatë periudhës korrik – shtator 2006, pranë shoqërive “****” in C.M *** G të B. Blvd, C.FL dhe “****”, *** H.L.D; bashkëlidhur kopje leje qëndrimi (*green card*), shuma afro 2,500 USD;
- të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës në vitet 2004 – 2006, bursë periudha 2004 – 2006, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 936,090 lekë;
- të ardhura nga puna si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudha tetor 2006 – dhjetor 2007, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 1,025,392 lekë;
- të ardhura nga puna si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudha janar 2008 – nëntor 2010, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 2,449,653 lekë;
- të ardhura nga puna si prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, periudha tetor 2010 e në vazhdim, bashkëlidhur vërtetimi, shuma 6,092,614 lekë;
- dieta të marra nga Ambasada Amerikane dhe departamenti amerikan i shtetit në seminarin njëmuor 17.2.2014 – 16.3.2014, në SHBA, të organizuar në bashkëpunim me Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë (bashkëlidhur kopje e certifikatës së trajnimit), shuma afro 900 USD.

4.3 Komisioni ka verifikuar të ardhurat e deklaruar nga subjekti dhe bashkëshortja dhe ka përfshirë në vlerësim ato të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore duke i bërë kështu pjesë të analizës financiare.

Deklarim i bashkëshortes së subjektit

5. Automjet tip “****”, me targë TR ***

5.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se disponon një automjet me targë TR ***, tip “****”, vit prodhimi 1998, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 19.2.2007. Vlera: 250,000 lekë. Zotërimi: 100 %.

5.2 Si burim krijimi deklarohen se kanë shërbyer: “*Kontratë kredie pranë Raiffeisen Bank, datë 12.2.2007, me afat 24 muaj, shlyer*”.

5.3 Për vërtetimin e deklarimeve të subjektit është administruar dokumentacion ligjor provues³².

5.4 Sipas kontratës së kredisë pranë Raiffeisen Bank, datë 12.2.2007, konfirmohet marrja e kredisë nga subjekti i rivlerësimit me afat 24 muaj, në shumën 400,000 lekë, kredi e mbyllur në datën 16.2.2009.

5.5 Sipas kontratës së mësipërme, qëllimi i dhënies së kredisë është “përdorimi për arsye personale”. Kredia është disbursuar në datën 16.2.2007 dhe bashkëshortja e subjektit ka kryer një tërheqje me vlerë 470,000 lekë, në datën 19.2.2007.

5.6 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shitjen e këtij automjeti për skrap, pranë personit fizik “Sh. D.”, me NIPT ***, me seli në Kashar, sipas procesverbalit të datës 23.12.2017. Vlera: 25,000 lekë.

5.7 Nga hetimi i Komisionit³³ rezulton se ky automjet është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 26.12.2017, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 102 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 9 “Përjashtimi nga pagimi i taksave kombëtare” të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, i ndryshuar.

5.8 Bazuar në faktet sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti që ishte kredia bankare e marrë nga bashkëshortja e subjektit.

6. Automjet tip “**”, me targë AA *****

6.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar automjet me targë AA ***, tip “****”, vit prodhimi 2002, motor naftë, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. **** kol., datë 14.8.2014, me vlerë 500,000 lekë. Zotërimi: 50% me bashkëshortin.

6.2 Si burim krijimi janë deklaruar se kanë shërbyer kursimet nga paga e dy bashkëshortëve (duke mos përcaktuar periudhë).

6.3 Për të vërtetuar deklaramet është paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁴.

6.4 Komisioni hartoi analizën financiare të mundësisë së subjektit dhe bashkëshortes për blerjen e këtij automjeti në datën 14.8.2014. Analiza fillon nga data 5.5.2014, datë në të cilën çelet depozita në vlerën 300,000 lekë nga bashkëshortja e subjektit. Teprica pozitive e mundësisë së çeljes së depozitës (263,812 lekë)³⁵ përfshihet në analizën e blerjes së automjetit tip “****”.

³² Shihni në dosjen e bashkëshortes së subjektit: kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2007, blerës E.K , të automjetit tip “****”, në vlerën 250,000 lekë; kontratë kredie bankare në Raiffeisen Bank datë 12.2.2007, marrë nga E.K , në shumën 400,000 lekë.

³³ Shihni shkresën e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 27.9.2021 në dosjen e subjektit dhe shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2019, në dosjen e bashkëshortes së subjektit ku informon lidhur me të dhënat për automjetin me targë TR ***.

³⁴ Shihni në dosjen e subjektit shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2021 e DPSHTRR dhe dosjen e bashkëshortes së subjektit: (1) vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (2) vërtetim page datë 10.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku rezulton se E.C ka përfituar për periudhën 15.12.2007 – 6.10.2010; (3) të ardhura nga puna pranë Q.Sh.D.Nj, pozicioni asistent koordinator, në periudhën Korrik - Shtator 2004; (4) të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, periudha tetor 2006 – nëntor 2007; (5) të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, periudha nëntor 2007 – mars 2010; (6) të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, periudha prill 2010 – tetor 2013; (7) të ardhura nga puna si gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, periudha nëntor 2013 e në vazhdim; (8) të ardhura nga puna si pedagog pranë universitetit “****”, Shkodër (shoqëria “****” sh.p.k.).

³⁵ Shihni pikën 7 të këtij vendimi.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit në datën 14.8.2014

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 6.5.2014 – 14.8.2014	257,018
Të ardhura bashkëshortja 6.5.2014 – 14.8.2014	281,254
Tepricë pozitive nga mundësia e çeljes së depozitës datë 5.5.2014	263,812
Të ardhura totale 6.5.2014 – 14.8.2014	802,085
Shpenzime jetese 6.5.2014 – 14.8.2014	128,332
Shpenzime udhëtimi 6.5.2014 – 14.8.2014	238,187
Shpenzime totale 6.5.2014 – 14.8.2014	366,519
Ndryshim likuiditeti 6.5.14 – 14.8.2014	-398,599
Blerje automjeti tip “****” datë 14.8.2014	500,000
Mundësia financiare	334,164

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në datën 14.8.2014 dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

6.5 Bazuar në vërtetimin e datës 6.2.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të kishte ndjekur ndonjë çështje gjyqësore me palën shitëse të pasurisë automjet.

6.6 Komisioni, bazuar në faktet e sipërpërmendura, nga hetimi administrativ kryesisht, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur më të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti.

7. Depozitë 12-mujore në Credins Bank

7.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se disponon një depozitë bankare çelur më 5.5.2014, në Credins Bank, me nr. ***. Vlera: 313,151 lekë. Zotërimi: 100%.

7.2 Si burim krijimi deklarohet se kanë shërbyer kursimet nga paga.

7.3 Për vërtetimin e deklarimeve të bëra bashkëshortja e subjektit ka paraqitur dokumentacion ligjor provues³⁶.

7.4 Nga hetimi i Komisionit, Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019, konfirmon se bashkëshortja e subjektit ka depozituar depozitë 12-mujore, në vlerën 313,151 lekë, në datën 19.1.2017.

7.5 Komisioni konstaton se kjo depozitë bankare është krijuar nga dy transfertat në datën 5.5.2014: (i) transfertë në shumën 260,000 lekë nga llogaria e Depozitës Plus te llogaria e depozitës 12-mujore; (ii) transfertë në shumën 40,000 lekë nga llogaria e pagës tek llogaria e depozitës 12-mujore të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë diferenca prej 13,151 lekësh përbëhet nga interesat bankarë të depozitës.

7.6 Komisioni hartoi analizën financiare të mundësisë së subjektit dhe bashkëshortes për çeljen e depozitës në vlerën 300,000 lekë, në datën 5.5.2014 si më poshtë:

³⁶ Shihni në dosjen e subjektit shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021, dhe dosjen e bashkëshortes së subjektit: (1) kontratë depozitë datë 11.2.2013 midis E.C dhe Credins Bank, hapur më 11.2.2013, në vlerën 50,000 lekë; (2) nxjerrje llogarie Credins Bank datë 19.1.2017 në emër të E.K, me gjendje në vlerën 313,151 lekë; (3) vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (4) vërtetim page datë 10.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku rezultoi se E.C ka përfutur për periudhën 15.12.2007 – 6.10.2010.

Analiza e mundësisë së krijimit të depozitës datë 5.5.2014

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura subjekti 1.1.2014 – 5.5.2014	414,847
Të ardhura bashkëshortja 1.1.2014 – 5.5.2014	424,934
Të ardhura totale 1.1.2014 – 5.5.2014	839,781
Shpenzime jetese 1.1.2014 – 5.5.2014	146,665
Shpenzime totale 1.1.2014 – 5.5.2014	146,665
Ndryshim likuiditeti 31.12.2013 – 5.5.2014	429,304
Mundësia financiare	263,812

7.7 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar depozitën në vlerën 300,000 lekë në datën 5.5.2014 dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

7.8 Bazuar në faktet sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e këtij likuiditeti.

8. Depozitë Plus në Credins Bank

8.1 Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se disponon një Depozitë Plus te Credins Bank, me nr. ***, datë 11.2.2013, rinovuar në datën 5.5.2014. Vlera: 266,001 lekë. Zotërimi: 100%.

8.2 Si burim krijimi janë deklaruar kursimet nga paga. Bashkëshortja e subjektit i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin ligjor justifikues³⁷.

8.3 Nga hetimi i Komisionit, Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019, konfirmon se znj. E.K disponon depozitë bankare në vlerën 266,001 lekë në datën 19.1.2017.

8.4 Komisioni konstaton se kjo depozitë bankare është krijuar me një depozitim fillestar në shumën 50,000 lekë, në datën 11.2.2013, në llogarinë e pagës, shumë e cila është transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e depozitës. Më pas, vlera e depozitës është shtuar me transferta periodike nga llogaria e pagës te llogaria e depozitës, duke nisur me 15,000 lekë/muaj përgjatë periudhës mars 2013 – prill 2014 e duke vazhduar me 20,000 lekë nga maji 2014 deri në fund të periudhës së hetuar nga Komisioni.

8.5 Referuar rezultatit pozitiv të analizës financiare të viteve 2013 – 2016, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin mundësi financiare të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite dhe shtesave të bëra në të, gjatë këtyre viteve, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

8.6 Bazuar në faktet sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e këtij likuiditeti.

9. Llogari rrjedhëse në Credins Bank

9.1 Në deklaratën *Vetting* 2017, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se disponon gjendje në llogari rrjedhëse me nr. ***, pranë Credins Bank. Vlera: 185,222 lekë. Zotërimi: 100%.

9.2 Si burim krijimi janë deklaruar kursimet nga paga.

³⁷ Shihni ekstraktin “Nxjerrje llogarie” në Credins Bank, datë 19.1.2017, në emër të znj. E.K , me gjendje në vlerën 266,001 lekë në dosjen e subjektit; shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021 dhe dosjen e bashkëshortes së subjektit.

9.3 Për të provuar deklaratimet është paraqitur dokumentacioni ligjor justifikues³⁸.

9.4 Nga hetimi i Komisionit, Credins Bank, me shkresën në dosjen e subjektit nr. *** prot., datë 15.10.2021 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2019, konfirmon se znj. E.K disponon llogari rrjedhëse me gjendje në 185,222 lekë, në datën 19.1.2017.

9.5 Komisioni konstatoi se gjendja e kësaj llogarie është akumuluar duke filluar nga viti 2013 e në vazhdim. Kreditimet në këtë llogari janë nga paga dhe të tjera (si depozitime apo rimbursime).

9.6 Referuar rezultatit pozitiv të analizës financiare të viteve 2013 – 2016³⁹, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin mundësi financiare të mjaftueshme për krijimin e kësaj depozite dhe shtesave të bëra në të, gjatë këtyre viteve, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

9.7 Bazuar në faktet sa më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të saktë, si dhe ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e këtij likuiditeti.

10. Analiza financiare

10.1 Analiza financiare për subjektin e rivlerësimit është hartuar nga Komisioni në dy pjesë kryesore. Pjesa e parë është bërë për periudhën tetor 2004 – 4.10.2006, referuar periudhës së Shkollës së Magjistraturës, të bërë nga subjekti, ku ai ka të ardhurat e para të vërtetuara me dokumentacion. Kjo periudhë analizohet në bllok për arsye se ai nuk ishte subjekt deklarues në këtë periudhë. Kjo analizë bëhet edhe për të parë mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti para fillimit të detyrës.

10.2 Pjesa tjetër e analizës financiare përfshin periudhën 5.10.2006 – 31.12.2016, në të cilën subjekti është deklarues pranë ILDKPKI-së, prandaj edhe analiza financiare është bërë vit pas viti për këtë hark kohor.

10.3 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamundësi financiare në vlerën -685,615 lekë për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës tetor 2004 – 31.12.2016.

10.4 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.5 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se: *“Në analizën e përgjithshme financiare e vetmja diferencë e konstatuar është diferenca përpara fillimit të detyrës në shumën 273,120 lekë. Diferenca e përlllogaritur në datën 5.1.2010 vjen për shkak të diferencës së gjendjes cash përpara detyrës dhe, si e tillë, nuk mund të dublohet.*

Bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit se diferenca të tilla bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit⁴⁰ nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, kam arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit”.

³⁸ (1) Nxjerrje llogarie në Credins Bank datë 19.1.2017, në emër të znj. E.K., me gjendje në vlerën 185,222 lekë; (2) vërtetim page datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁹ Shihni analizën financiare të viteve 2013 – 2016 në pikën 10 të këtij vendimi.

⁴⁰ Subjekti ka cituar 4 vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për të nënvizuar raste konfirmimi me pamundësi financiare: nr. 38, datë 6.12.2021; nr. 2, datë 2.2.2023, nr. 4, datë 16.2.2023; nr. 19, datë 10.6.2022.

Vlerësimi i Komisionit

10.6 Pas përgjigjes së subjektit ndaj rezultateve të hetimit, Komisioni hartoi edhe një herë analizën financiare të periudhës tetor 2004 – 31.12.2016 si më poshtë:

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: BEZART B. KACKINI													
PERSHKRIMI	Tet 2004 - 04.10.06	05.10.06 - 31.12.06	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	1,065,559	58,027	506,433	-58,789	727,584	2,979,620	18,656	279,536	403,851	810,473	759,346	239,922	6,020,000
Apartament 91.1 m2, ***, Tirane - 38,260€ - 100% - 2010						5,270,000							5,270,000
Automjet Volkswagen **** - 500,000 leke - 50% - 2014										500,000			500,000
Automjet Opel **** - 250,000 leke - 100% - b/shortja - 2007								250,000					250,000
Ndryshim ne likuiditet	1,065,559	58,027	506,433	-58,789	727,584	-2,290,380	18,656	29,536	403,851	310,473	759,346	239,922	
DETYRIME	0	0	0	0	0	2,751,960	-414,900	-419,160	-280,420	0	0	0	1,637,480
Hua nga babai i subjektit per blerje apartamenti - 2010						1,653,600							1,653,600
Hua nga kusherira e subjektit per blerje apartamenti - 2010						1,098,360	-414,900	-419,160	-280,420				-16,120
													0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	1,065,559	58,027	506,433	-58,789	727,584	227,660	433,556	698,696	684,271	810,473	759,346	239,922	4,382,520
TE ARDHURA TE DOKUMENTUARA	936,090	191,735	852,719	977,061	969,095	1,009,408	1,023,584	2,228,963	1,878,498	2,159,920	2,180,188	2,195,157	16,602,418
Te ardhura nga bursa dhe paga subjekti	936,090	191,735	838,409	928,653	969,095	1,009,408	1,023,584	902,245	922,666	1,032,792	1,053,568	1,073,421	10,881,666
Te ardhura nga paga bashkeshortja								867,366	856,459	1,098,835	1,104,225	1,101,490	5,028,375
Te ardhura nga dhurimet e familjareve per dasem								195,000					195,000
Te ardhura nga pasuri paramartesore te b/shortes								250,807					250,807
Te ardhura nga interesat e depozites Raiffeisen subjekti			14,310	48,408									62,718
Te ardhura nga interesat e depozites Credins b/shortja											7,650	5,501	13,151
Te ardhura si pedagog Universiteti Gj. B., Shkoder+ lehtesues tek Sh. Magjistratures								13,545	99,373	28,293	14,745	14,745	170,701
SHPENZIME	215,216	27,389	169,620	189,866	172,620	201,172	418,216	633,352	401,173	678,183	689,728	1,384,181	4,965,501
Shpenzime jetese	215,216	27,389	136,620	136,620	136,620	136,620	136,620	279,096	282,048	439,996	448,552	470,184	2,845,581
Shpenzime qiraje ne Tropoje 2007 - 2010			33,000	36,000	36,000	9,000							114,000
Shpenzime mjekesore b/shortja - 2016												700,000	700,000
Shpenzim nga terheqjet bankare													0
Shpenzime mobilimi						50,000	265,000	354,256	100,000		9,490		778,746
Shpenzime udhetimi		0	0	17,246	0	5,552	16,596	0	19,125	238,187	231,686	213,997	742,390
ANALIZA E DOKUMENTUAR	-344,684	106,319	176,666	845,984	68,891	580,575	171,812	896,915	793,053	671,263	731,115	571,054	5,268,962
										Pamundesia financiare totale			-344,684
Gjendje CASH (sipas deklarimeve periodike)	800,000	800,000	800,000	1,050,000	1,950,000	0	0	0	0	0	0	0	
LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	1,065,559	1,123,585	1,630,019	1,571,230	2,298,814	8,434	27,091	56,627	460,478	770,951	1,530,297	1,770,219	

10.7 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja kishin pamundësi financiare totale në vlerën -344,684 lekë për shtimin e pasurive dhe likuiditeteve, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës tetor 2004 – 31.12.2016.

10.8 Kjo pamundësi financiare rezultoi për periudhën e fillimit të detyrës, bazuar në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës (më 1.11.2006).

10.9 Trupi gjykues, bazuar në parimin e proporcionalitetit, nuk e konsideroi këtë pamundësi financiare për penalizimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

11. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe bashkëshortes, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga BKT-ja, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Tirana Bank, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat e subjektit nga bursa e Shkollës së Magjistraturës (2004 – 2006), pagat e subjektit si: gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (2006 – 2007); gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë (2007 – 2010); gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (2010 – 2013); gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (2013 – 2016), lehtësues tek Shkolla e Magjistraturës (2015 – 2016).

ii) Të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia në universitetin privat “****” (***, 2012 – 2014). Këto të ardhura janë marrë sipas vërtetimeve nga ISSH-ja⁴¹ për të cilat vërtetohet se janë paguar detyrimet tatimore.

iii) Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit: nga bursa e Shkollës së Magjistraturës (2004 – 2006), pagat si prokurore pranë Prokurorisë tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2006 – 2007 dhe 2010 – 2016), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (2008 – 2010).

iv) Të ardhurat nga pasuri paramartesore e bashkëshortes (automjeti) – 2012.

v) Të ardhurat nga interesat e depozitës së subjektit tek Raiffeisen Bank (2007 – 2008) dhe të ardhurat nga interesat e depozitës së bashkëshortes tek Credins Bank (2015 – 2016).

vi) Të ardhurat nga dhurimet e familjarëve për dasmë (2012). Vërtetohet mundësia e familjarëve të bashkëshortes për të dhuruar shumën e deklaruar prej 100,000 lekësh (të ardhurat totale 23,087,370 - shpenzime jetike 4,819,072 lekë).

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (në shpenzimet e përcaktuara nga ILDKPKI-ja sipas INSTAT-it);

ii) Shpenzime qiraje në Tropojë, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit (2007 – 2010);

iii) Shpenzime mjekësore, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje pyetësori (2016);

iv) Shpenzime mobilimi, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje pyetësori (2010 – 2013 dhe 2015);

v) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/

⁴¹ Shihni përgjigjen nga ISSH-ja nr. *** prot., datë 20.9.2021.

bashkëshortja kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat janë dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

- d. Në vlerat e pasurive të luajshme dhe të paluajshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive⁴².
- e. Në vlerat e huamarrjeve, sipas kontratës së huas dhe deklaratës noteriale mes subjektit, babait dhe shtetas E. D. në vitin 2010, si dhe kthimet e huas sipas deklarimeve të subjektit në vitet përkatëse (2010 – 2013).

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

12. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në prova dhe bindjen e brendshme, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, si dhe justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, duke zbritur edhe shpenzimet e jetesës, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

13. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin e deklasifikuar plotësisht për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

13.1 Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

13.2 Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Bezart Kaçkini.

13.3 Me shkresën nr. *** prot., datë 1.11.2023, i është kërkuar AKSIK-së përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës së subjektit Bezart Kaçkini.

13.4 AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2024, ka dërguar raportin e Grupit të Punës nr. ***, datë 31.10.2017. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 17.1.2024, të KDZH-së.

13.5 Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja, ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit Bezart Kaçkini, Komisioni ka kryer hetim administrativ, nga ku rezulton se:

- nuk ka asnjë informacion apo indicie që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës sipas dokumentacionit të administruar;
- nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit;
- nuk ka të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara;

⁴² Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e luajshme dhe të paluajshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

- nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

14. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për subjektin Bezart Kaçkini nuk u gjetën elemente, që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

14.1 Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

15. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15.1 Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: aftësive profesionale; aftësive organizative; etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe aftësive personale dhe angazhimit profesional.

15.2 Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (a) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (b) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (c) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

15.3 Subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini, në periudhën tetor 2006 – nëntor 2007, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; për periudhën nëntor 2007 – prill 2010 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; për periudhën prill 2010 – nëntor 2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; për periudhën nëntor 2013 – aktualisht, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka deklaruar gjithashtu se në periudhën qershor 2015 – mars 2016 ka qenë *lehtësues* në trajnimet e kryera pranë Shkollës së Magjistraturës.

15.4 Formulari paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Të gjitha rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe. 1962 është totali i çështjeve të vendimuara nga data 4.11.2013 deri më 7.10.2016.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 21.5.2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regjistrimi 22.1.2014, që i përket palëve: paditës shoqëria “****” s. a.; i paditur: D.R.T Tiranë dhe A.Sh me objekt “Konstatim i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ etj.”.

Për këtë vendim është konstatuar se gjykimi ka zgjatur afërsisht katër muaj, pra gjykimi ka tejkaluar standardin kohor njëmuajor të parashikuar nga neni 5, shkronja “c” e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin nr. ***, datë 23.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Dokumenti 2. Vendimi gjyqësor nr. ***, datë 2.6.2015, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. *** regj. them., datë regjistrimi 23.10.2014.

Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Gjykimi ka zgjatur shtatë muaj e dhjetë ditë, pra gjykimi ka tejkaluar standardin kohor njëmuajor të parashikuar nga neni 5, shkronja “c” e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”. Gjyqtari ka pasqyruar në përmbajtje të vendimit se çështja ka qëndruar e pezulluar nga data 6.3.2015 deri në datën 26.5.2015, për shkak të shqyrtimit të njëpasnjëshëm nga trupa gjyqësore e gjykatës e disa kërkesave të paditësit për përjashtimin e z. Bezart Kaçkini nga gjykimi i çështjes. Kjo periudhë çmohet se ka ndikuar në zgjatjen e gjykimit.

Dokumenti 3. Vendimi gjyqësor nr. ***(***), datë 4.7.2016, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes nr. ***(***) regj. them., datë regjistrimi 3.5.2016.

Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm. Gjykimi ka zgjatur dy muaj, pra gjykimi ka tejkaluar standardin kohor njëmuajor të parashikuar nga neni 5, shkronja “c” e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

16. Në përfundim të hetimit, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me afatet e gjykimit për këto 3 çështje dhe, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti, lidhur me tri dokumentet e paraqitura ka shpjeguar se: *“Lidhur me çështjen datë 22.1.2014 regjistrimi, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.5.2014, shpjegoj se në kohëzgjatjen e gjykimit kanë ndikuar edhe faktorët sa vijon:*

Në periudhën 27-31 janar kam qenë gjyqtar i gatshëm për gjykimin e kërkesave me karakter të ngushtshëm (bashkëlidhur vendim i kryetarit të gjykatës për miratimin e grafikut të gatishmërisë). Po ashtu, në këtë periudhë, kam ndjekur edhe seminare të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, në datat 13 mars dhe 22-23 prill, ku pjesëmarrja është e detyrueshme për magjistratët. Kjo periudhë ka pasur edhe shumë festa zyrtare, Dita e Verës, Pashkët Katolike dhe Ortodokse, Sulltan Novruzit dhe 1 Maji, duke e reduktuar në këtë mënyrë javën zyrtare të punës. Po ashtu, në harkun kohor 22.1.2014 – 21.5.2014 kam përfunduar me vendim përfundimtar sipas një përllogaritjeje të thjeshtë, afro 200 mosmarrëveshje me palë, me një mesatare prej 50 seanca çdo javë (bashkëlidhur dhe kopje të agjendës së gjyqtarit në funksion të të provuarit të ngarkesës ditore). Sa i përket mosmarrëveshjes objekt gjykimi, kam besuar se nisur edhe nga vlera e konsiderueshme financiare, si dhe nga problematikat e ngritura nga palët, ky rast ka kërkuar një kujdes të shtuar, çfarë ka imponuar konsultimin me legjislacionin fiskal, procedural administrativ dhe civil, si dhe me praktikën më të mira, çka ka passjellë trajtimin e rastit edhe në tejkalim të afatit njëmuajor.

*Lidhur me referencën njëmuajore si afat gjykimi në shkallë të parë do të doja të parashtroja se sa i përket raportit midis zbatimit të standardeve të gjykimit, të miratuara me vendimin nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD-së, dhe zbatimit të përcaktimeve ligjore përkatëse, vlerësoj se përparësi ka zbatimi i ligjit organik, në bazë të të cilit ushtron funksionin magjistrati. Në rastin konkret, i zbatueshëm është ligji organik nr. 49/2012. Ky i fundit, në nenin 3, si parim të përgjithshëm sanksionon gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, por pa sanksionuar afat maksimal për gjykimin e çështjeve. Nga ana tjetër, ligji nr. 49/2012, përcakton afate për veprimet përgatitore (neni 25), seancën gjyqësore (neni 27), por nuk përjashton mundësinë e zgjatjes së këtyre afateve, veçanërisht kur ato kanë qenë për shkaqe të përligjura. Në gjetjet e Komisionit afatet kanë ardhur për shkak të pamundësisë objektive, kryesisht për shkak të zënies së të gjithë kohës fizike me procese gjyqësore, që kanë çuar në pamundësi fizike kohore për të respektuar të vetmin afat të përcaktuar që është ai i dorëzimit të vendimit të arsyetuar që është 7 ditë. Gjithsesi, parë në raport me pritshmërinë për të cilën ishin krijuar gjykatat administrative, e gjej të drejtë dhe objektiv konstatimin e Komisionit.*

Lidhur me vendimin gjyqësor nr. *, datë 2.6.2015**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes me datë regjistrimi 23.10.2014, shpjegoj sa vijon:

Çështja ka qenë e pezulluar nga data 6.3.2015 deri në datën 26.5.2015, për shkak të shqyrtimit të njëpasnjëshëm nga trupa gjyqësore e Gjykatës Administrative të disa kërkesave të paditësit A. B. për përjashtimin tim si gjyqtar-relator nga gjykimi i çështjes.

Po ashtu, në këtë periudhë ku është shtrirë gjykimi, në datat 12-18 janar 2015 kam qenë gjyqtar i gatshëm për shqyrtimin e kërkesave me karakter të ngutshëm (bashkëlidhur urdhri i Kryetarit për miratim të grafikut të gatishmërisë), periudhë që përkon me procesin e mbartjes së dosjeve, si dhe në seminare pranë Shkollës së Magjistraturës, në datat 30 janar, 10 shkurt, 23 shkurt, 12 mars apo edhe ditët e festave zyrtare.

Lidhur me vendimin gjyqësor nr. *, datë 4.7.2016**, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që i përket dosjes me datë regjistrimi 3.5.2016, shpjegoj sa vijon:

Çështja në fakt ishte e veçantë dhe komplekse, e rrallë, për mos thënë e vetme në gjykim pranë Gjykatës Administrative. Kjo mosmarrëveshje, që çmoj se ka pasur një impakt të padiskutueshëm në jetën akademike, ka pasur shumë palë ndërgjyqëse me shumë përfaqësues secili, ku secila nga palët ka pasur pretendime, të cilat duhej t'u njoftoheshin palëve të tjera, si dhe duhej kohë për t'u vlerësuar nga palët dhe gjykata. Në harkun dymujor janë kryer shumë veprime procedurale me dhe pa palë ndërgjyqëse, mes të cilave është bërë edhe këqyrja e sendit në prani të palëve, që konsiston në verifikimin e kodeve të sekretimit të kutive, në hapjen e kutive të votimit dhe rinumërimin e votave. Shpreh bindjen time se kjo mosmarrëveshje kërkonte kohën e duhur për t'u zgjidhur drejt, ndaj duke marrë në konsideratë elementet e sipërcituara, çmoj se kohëzgjatja dymujore duhet vlerësuar si afat i arsyeshëm për rastin objekt gjykimi”.

Vlerësimi i Komisionit

17. Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me 3 çështjet-dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika. Shpjegimet e tij ishin bindëse dhe të plota.

Përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Dosja 1. Çështja administrative nr. *** regjistri them., datë 17.2.2014 regjistrimi, që i përket paditëses A. M., kundër të paditurit D.R.S.Sh Tiranë, me objekt: “Anulimin e urdhrit të pezullimit të pensionit nr. ***, datë 24.2.2011”.

Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 21.4.2014. Në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

Me shortin e datës 19.2.2014, ajo i është caktuar subjektit të rivlerësimit, gjyqtarit Bezart Kaçkini.

Gjyqtari Bezart Kaçkini, në datën 20.2.2014, ora 14:30, ka kryer veprime përgatitore në dhomë këshillimi, të cilat i ka dokumentuar me procesverbal. Në procesverbal relatohet se pasi ka studiuar dosjen, gjyqtari në bazë të nenit 25 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vërejtë se padia nuk ka të meta, prandaj vendosi njoftimin e saj bashkë me provat që e shoqërojnë palën e paditur dhe A.Sh. Urdhërohet që pala e paditur të depozitojë në gjykatë prapësimet me shkrim, provat me të cilat mbështet prapësimet etj. Afati i depozitimit të prapësimeve është 10 ditë, duke filluar nga dita që pala e paditur merr dijeni për kërkesëpadinë.

Në vijim janë kryer edhe 3 seanca gjyqësore më 10.3.2014, 31.3.2014 dhe 15.4.2014, ku gjyqtari në bazë të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile i dha fund hetimit gjyqësor dhe ftoi palët në kërkimet përfundimtare në seancën në datën 21.4.2015. Gjyqtari është tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar dhe në kthim ka disponuar “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 8.7.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 21.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rezultoi se ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin e datës 23.6.2017 ka vendosur mospranimin e rekursit.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar nga gjyqtari Bezart Kaçkini në kryesekretarinë e gjykatës në datën 7.5.2014, pas 17 ditëve nga shpallja e vendimit, duke shkelur afatin 7-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 2 muaj e 2 ditë, në intervalin kohor 19.2.2014 – 21.4.2014. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Vlerësojmë se menaxhimi i çështjes nga gjyqtari Bezart Kaçkini nuk paraqet probleme.

Gjyqtari Kaçkini, në respektim të afatit kohor 7-ditor të parashikuar nga neni 25, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, ka vënë në lëvizje çështjen duke kryer veprime përgatitore në dhomë këshillimi. Gjithsej janë caktuar e zhvilluar 3 seanca, ku të tria seancat ishin produktive.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Arsyetohet se padia duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj, por edhe në fakte. Argumentohet se padia është e pabazuar në ligj për shkak se padia është ngritur jashtë afatit ligjor. Gjyqtari arsyeton se padia është ngritur si jashtë afatit ligjor të parashikuar si nga Kodi i Procedurës Civile, ashtu edhe jashtë afatit ligjor të parashikuar nga ligji nr. 49/2012.

Gjithashtu, arsyetohet se padia është e pabazuar edhe në prova. Gjyqtari analizon prapësimet e palës së paditur në raport me secilën provë të shqyrtuar prej tij dhe i konsideron ato prapësime të bazuara në fakte. Gjyqtari analizon pretendimet e paditëses në raport me përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe i vlerëson ato të pabazuara në fakte. Pra, çmohet se padia duhet rrëzuar në themelin e pretendimeve të saj.

Në përfundim të hetimit subjektivit iu kërkua të jepte shpjegime lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit në sekretarinë gjyqësore dhe afatin e gjykimit të çështjes

Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se: *“Në rastin objekt gjykimi kam mendimin se për rrethanat kur është zhvilluar gjykimi, të renditura në pjesën hyrëse të shpjegimeve, ka qenë objektivisht e pamundur që gjykimi të përfundohej në një afat më të shpejtë. Në këtë periudhë, mesatarja javore e seancave ka qenë afro 50, ndërsa e vendimeve mbi 10 (bashkëlidhur kopje të agjendës së gjyqtarit).*

Sa i përket dorëzimit të dosjes në kryesekretari, duke marrë në konsideratë faktin se sekretaret gjyqësore kanë pasur një ngarkesë të jashtëzakonshme, shkaktuar si rezultat i fluksit të madh të çështjeve të ardhura nga gjykatat e rretheve gjyqësore si rezultat i vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, lidhur me çështjet e kompetencës lëndore, si dhe kualifikimin e mangët të tyre, çmoj se afati 17-ditor nuk duhet të konsiderohet penalizues për rrethanat në të cilat ka ndodhur. Theksoj se administrimi i dosjes gjyqësore përfshin disa procese, nga renditja e akteve procedurale, te printimi dhe nënshkrimi i vendimit, te inventarizimi dhe lidhja e dosjes, për t’u përmbjllur me dorëzimin e saj tek nëpunësi i autorizuar në k/sekretarinë e gjykatës. Së fundmi, afati nuk ka cenuar të drejtën e ankimit të paditësit, të cilit vendimi i është shpallur në çdo rast i arsyetuar në mënyrë të përmbledhur verbalisht. Në rastin objekt gjykimi, paditësi e ka ushtruar këtë të drejtë përmes apelimit drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ”.

Dosja 2. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 5.6.2014 regjistrimi, që i përket paditëses F. R., kundër të paditurve D.R.S.Sh Dibër, I.S.Sh Tiranë, me objekt “Shfuqizimi i aktit administrativ”

Kjo çështje e subjektit si gjyqtar i vetëm ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 17.10.2014.

Gjyqtari Bezart Kaçkini, në datën 11.6.2014, ora 8:30, ka kryer veprime përgatitore në dhomë këshillimi, të cilat i ka dokumentuar me procesverbal të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Në dosje nuk ka procesverbal të veprimeve përgatitore të mbajtur në datën 20.6.2014, por rezultoi se prapësimet dhe provat e palës së paditur janë depozituar në gjykatë, në datën 25.6.2014, në orën 12:30. Prej datës 25.6.2014 deri në datën 21.7.2014 nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera përgatitore në dhomë këshillimi, por sipas fletëthirrjeve të ndodhura në dosje, në datën 21.7.2014, gjyqtari Bezart Kaçkini ka caktuar zhvillimin e një seance përgatitore me praninë e palëve, e cila do të zhvillohej në datën 15.9.2014, ora 10:30.

Janë zhvilluar gjithsej 5 seanca gjyqësore dhe në seancën përfundimtare është vendosur “Pranimi i kërkesëpadisë”.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 4 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 6.6.2014 – 17.10.2014. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “c” e Aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhen kërkesëpadiat dhe provat e paraqitura nga palët, procesverbali i veprimeve përgatitore sipas nenit 25, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, procesverbali i seancave përgatitore dhe procesverbali i seancave gjyqësore, aktet e njoftimit dhe vendimi gjyqësor përfundimtar. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Ky vendim plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Sa më sipër, lidhur me afatin e gjykimit të çështjes, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Palë në gjykim ka qenë një qytetare dhe një organ administrativ me seli jashtë selisë së Gjykatës Administrative. Konkretisht, paditësi F. R., me banim në fshatin D, bashkia Dibër dhe e paditur DRSSH Dibër, me seli në Peshkopi. Paditësi nuk është asistuar nga avokat mbrojtës dhe nuk ka pasur përfaqësues ligjor në gjykim, ndërkohë që DRSSH Dibër është përfaqësuar në gjykim me autorizim nga juristët e DRSSH-së Tiranë, çka e ka vështirësuar procesin e mbledhjes dhe të analizimit të provave. Tjetër rrethanë që duhet marrë në konsideratë, është edhe periudha e pushimeve vjetore në muajin gusht që, praktikisht, afati i gjykimit, nëse i heqim muajin gusht, zbret në 3 muaj e 13 ditë. Gjithashtu, në këtë periudhë kam ndjekur seminarin pranë Shkollës së Magjistraturës në datat 4-6 korrik dhe 4-5 shtator. Ndërsa në datën 10 tetor është zhvilluar konferenca gjyqësore. Po ashtu, në datat 29 shtator deri më 4 tetor kam qenë gjyqtar i gatshëm për gjykimin e kërkesave me karakter të ngutshëm”.*

Dosja 3. Çështja administrative nr. *** regjistri, datë 8.6.2015 regjistrimi, që i përket paditësit subjekti tatimor D.T., kundër të paditurve D.R.T Tiranë dhe D.P.T, me objekt “Anulimi/shfuqizimi i vendimit të D.A.T”.

Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 2.10.2015.

Në datën 10.6.2015, ora 13:30, subjekti i rivlerësimit, në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve, ka kryer veprime përgatitore të dokumentuara me procesverbal. Në procesverbal relatohet se padia ka të meta, nuk është paguar taksa gjyqësore dhe nuk i është bashkëngjitur akti administrativ objekt gjykimi.

Janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore dhe seanca e datës 2.10.2015 është çelur në orën 11:30 dhe është dokumentuar me procesverbal. Nuk sqarohet arsyeja e mosregjistrimit audio të seancës. Në përfundim, gjyqtari u tërhoq për marrjen e vendimit përfundimtar, ku ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e datës 24.1.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** (***) , datë 2.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 3 muaj e 23 ditë, në intervalin kohor 9.6.2015 – 2.10.2015. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkaluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “c” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

Çështja u vu në lëvizje nga gjyqtari në respektim të afatit kohor 7-ditor, të parashikuar nga neni 25, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë, vlerësohet si mangësi fakti që në seancat si përgatitore, ashtu edhe gjyqësore, nuk shënohet as ora e fillimit dhe as ora e mbarimit të seancës.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Lidhur me gjetjet e mësipërme dhe mbi afatin e gjykimit të çështjes, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Në afatin e gjykimit vlerësoj se kanë ndikuar edhe rrethanat që kanë të bëjnë me pamundësinë e njoftimit të paditësit për të metat e padisë, njoftim i cili është bërë i mundur vetëm përmes emrit tregtar “***”. Pas plotësimit të të metave të padisë, gjykimi ka vijuar normalisht. Po ashtu, në këtë periudhë kam qenë në seminare: datat 11-12 qershor në Gjykatën e Lartë; 29-30 qershor e 9-10 korrik në Shkollën e Magjistraturës. Këtyre duhet t’u shtohen dhe ditët e festave zyrtare të Bajramit të Madh dhe Kurban Bajramit, së bashku me muajin gusht, në të cilin konsumohet leja e zakonshme vjetore.*

Lidhur me mosarsyetimin e mosregjistrimit audio të seancës, për shkak të kohës së gjatë nuk jam në gjendje të jap një shpjegim. Parimisht, në 100% të rasteve, kur është e mundur, i kam zhvilluar seancat në sallë dhe i kam dokumentuar në sistemin e regjistrimit audio”.

Dosja 4. Çështja administrative nr. *** regjistri themeltar, datë 24.3.2016 regjistrimi, që u përket paditësve A. Sh. dhe Y. Sh. kundër të paditurit ZVRPP Tiranë, me objekt “Shfuqizimi i aktit administrativ”.

Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. *** , datë 12.5.2016. Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

Në datën 30.3.2016, ora 13:45, gjyqtari Bezart Kaçkini, në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve, ka kryer veprime përgatitore të dokumentuara me procesverbal.

Seanca e parë përgatitore e datës 25.4.2016 është çelur në orën 12:30 dhe është dokumentuar me procesverbal.

Janë zhvilluar edhe 2 seanca gjyqësore, ku në përfundim gjyqtari mbyll shqyrtimin gjyqësor, tërhiqet për marrjen e vendimit përfundimtar, duke vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë”.

Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim paditësit, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e padisë. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. *** (***) , datë 4.10.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. *** , datë 12.5.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 1 muaj e 17 ditë, në intervalin kohor 25.3.2016 – 12.5.2016. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkalluar afatin standard prej 1 muaji, të përcaktuar nga pika 5, shkronja “c” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhen kërkesëpapia dhe provat e paraqitura nga palët, procesverbali i veprimeve përgatitore sipas nenit 25, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, procesverbali i seancës përgatitore, procesverbali i seancës gjyqësore, aktet e njoftimit dhe vendimi gjyqësor. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Vendimi gjyqësor i dhënë nga subjekti i rivlerësimit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Sa më sipër, lidhur me afatin e gjykimit të çështjes, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar se: *“Në rastin konkret mendoj se në afatin e gjykimit ka ndikuar thellimi në hetimin e elementëve formalë të padisë, në drejtim të pasjes legjitimitet aktiv të paditësve dhe pasiv të palës së paditur. Veç saj, në këtë hark kohor kam ndjekur seminarin pranë Shkollës së Magjistraturës në datat 24-25 mars dhe 21-22 prill, ndërkohë që në datën 3 maj është zhvilluar analiza e gjykatës në prezencë të drejtuesve të KLD-së. Po ashtu, në këtë periudhë ka pasur prezencë të festave zyrtare që janë pushim dhe, për pasojë, zvogëlohet numri i ditëve të punës, në të cilat mund të zhvillohet veprimtari gjyqësore”*.

Dosja 5. Çështja gjyqësore nr. *** regjistri, datë 5.2.2014 regjistrimi, që i përket paditësit T.H., kundër të paditurit D.R.S.Sh Tiranë, me objekt “Detyrimin për të paguar diferencën e papaguar për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi”. Kjo çështje ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.4.2014. Subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Bezart Kaçkini, ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

Në datën 7.2.2014, ora 15:15, subjekti i rivlerësimit, në dhomë këshillimi dhe pa praninë e palëve, ka kryer veprime përgatitore të dokumentuar me procesverbal.

Seanca e parë përgatitore e datës 25.2.2014 është çelur në orën 10:30 dhe është dokumentuar me procesverbal me shkrim, kurse seanca e dytë përgatitore është e datës 21.3.2014.

Në vijim është zhvilluar edhe një seancë e datës 7.4.2014, ku gjyqtari u tërhoq për marrjen e vendimit përfundimtar duke vendosur “Pranimin pjesërisht të kërkesëpadiës”.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 29.9.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 7.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë... etj”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. *** (***), datë 8.5.2017, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 29.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues”.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtari Bezart Kaçkini janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës, në datën 29.4.2014 – brenda 22 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit, pra, në shkelje të afatit 7-ditor të përcaktuar nga neni 42, pika 3 e ligjit nr. 49/2012.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 2 muaj e 1 ditë, në intervalin kohor 6.2.2014 – 7.4.2014. Kohëzgjatja e gjykimit ka tejkalluar afatin standard 1-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “c” e aneksit 1 të sistemit të vlerësimit.

Gjithsej janë caktuar e zhvilluar 3 seanca (2 seanca përgatitore me praninë e palëve dhe 1 seancë gjyqësore) dhe vetëm një seancë ishte joproductive, seanca e parë përgatitore, për shkak se mungoi paditësi dhe gjyqtari vendosi t’i japë mundësinë të paraqitej në një seancë tjetër.

Vendimi përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural civil dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Vendimi gjyqësor i mësipërm i dhënë nga subjekti i rivlerësimit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar.

Lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit në sekretarinë gjyqësore dhe afatin e gjykimit të çështjes, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, i cili në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar: *“Jam i mendimit se në kohëzgjatjen e gjykimit kanë ndikuar, veç ngarkesës në punë, edhe sjellja e palëve, të cilat, ashtu sikurse dhe vetë gjykata që ishte në fillimet e veprimtarisë së saj, palët nuk kanë qenë efektive, duke mos iu përgjigjur në kohë thirrjes së gjykatës për parashtrime dhe akte provuese. Lidhur me vonesën në dorëzimin e fashikullit të gjykimit në kryesekretari, sikurse kam shpjeguar më lart, viti 2014 përkon me një volum të pazakontë çështjesh të paraqitura për zgjidhje. Në periudhën 7-18 prill, referuar kalendarit të gjykimit të çështjeve, kam zhvilluar mesatarisht 12 seanca në ditë dhe kam dhënë mbi 40 vendime. Praktikisht, zbardhja, printimi i vendimeve, renditja e akteve dhe administrimi i fashikullit të gjykimit janë bërë që të gjitha pas mbylljes së orarit zyrtar të punës, 16:00, si dhe në ditët e shtuna e të diela. E theksoj se vonesat në gjykim dhe në dorëzim të fashikullit të gjykimit, që me të drejtë janë konstatuar nga Komisioni, në asnjë rast nuk janë rezultat i neglizhencës apo tendencave zvarritëse nga ana ime si gjyqtar, por vetëm si rezultat i ngarkesës së paprecedentë në punë”.*

Vlerësimi i Komisionit lidhur me pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short

18. Shpjegimet e paraqitura nga subjekti për këto raste ishin të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer shkelje procedurale dhe se vonesat kanë qenë të justifikuar, referuar numrit të madh të çështjeve të shortuara për subjektin e rivlerësimit.

18.1 Për sa më sipër, nuk u konstatuan problematika lidhur me pesë çështjet e përzgjedhura me short për subjektin e rivlerësimit.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

19. Me Dekretin nr. ***, datë 16.7.2013, të Presidentit të Republikës, emërohet gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku vazhdon të ushtrojë detyrën edhe aktualisht.

20. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtarin Bezart Kaçkini janë paraqitur 4 ankesa (2 ankesa në vitin 2014 dhe 2 ankesa në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

20.1 4 ankesat janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:

- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar bazuar mbi informacionin e vetë kryetarit për zvarritje, i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje, është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara;
- 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, është arkivuar me arsyetimin se pretendimet janë të pabazuara;
- 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal ligji, i është dërguar për trajtim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

20.2 Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Bezart Kaçkini përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

DENONCIME NGA PUBLIKU

21. Pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit Bezart Kaçkini janë administruar 6 denoncime nga publiku, si vijon:

21.1 Denoncim nr. * prot., datë 25.6.2018, i shtetases T.Ç**

Kjo shtetase ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit Bezart Kaçkini, duke pretenduar se ai ka kryer një proces jo të rregullt ligjor, ka kryer shkelje të etikës profesionale. Ajo ankohet se asnjë prej subjekteve të përmendura nuk marrin asnjë masë ndaj përmbarueses E. M, e cila ka ekzekutuar vendimin fshehurazi dhe nuk i ka kthyer detyrimin. Ndër dokumentet e tjera bashkëlidhur denoncimit të T. Ç. gjendet edhe vendimi nr. ***, datë 27.3.2013, i cili ka palë paditëse denoncuesen T. Ç. dhe palë të paditur përmbaruesen private E. M., ku i kërkon gjykatës kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, konkretisht vendimin nr. ***, datë 28.12.2012. Në seancën e veprimeve përgatitore të datës 27.3.2013, pala paditëse ka paraqitur kërkesë me shkrim, me anën e së cilës kërkon pushimin e gjykimit të çështjes, pasi do t'i drejtohej me kërkesë Z.P Shkodër.

Në fakt, në formularin e denoncimit, denoncuesja liston edhe emrin e subjektit të rivlerësimit, z. Bezart Kaçkini, por denoncimi i saj është i fokusuar për emra të tjerë (prokurorë dhe gjyqtarë), për të cilët ankohet konkretisht. Ndërsa, për sa i përket dokumentit, vendim i sipërcituar me gjyqtar subjektin e rivlerësimit, konstatohet se ai vendim nuk mund të jetë objekt vlerësimi nga ana jonë, duke parë që denoncuesja ka kërkuar me vullnetin e saj pushimin e gjykimit për çështjen e saj.

Në këto kushte nuk kishte vend për hetim të mëtejshëm në adresë të subjektit të rivlerësimit.

21.2 Denoncim nr. * prot., datë 24.7.2020, i shtetases S.B**

Kjo shtetase ka denoncuar shumë subjekte rivlerësimi, ndër to edhe subjektin e rivlerësimit, z. Bezart Kaçkini, të cilët sipas denoncueses nuk kanë vepruar nga paaftësia, por kanë qenë të njëanshëm, kanë pranuar ndërhyrje dhe në ndonjë rast janë korruptuar. Shtetasja e fillon denoncimin e saj ndaj përmbarueses E.M, të cilën, së bashku me djalin e saj e ka paditur për shkatërrim e grabitje prone dhe në vitin 2020 ajo është akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Rrethanat e çështjes

Denoncuesja, së bashku me djalin e saj, kanë pasur në zotërim një dyqan me sip. 50 m², të përfituar me kontratën e shitblerjes së vitit 1997 dhe të regjistruar pranë ZVRPP-së Shkodër. Ndërkohë, disa vite më vonë, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ka bërë pronar të një trualli 32 m² V. R etj., duke krijuar mbivendosje me një pjesë të dyqanit në pronësi të paditëses S B. Për lirimin e kësaj pjese të dyqanit trashëgimtarët e V. R i janë drejtuar gjykatës me padi për kthim sendi, sipërfaqe trualli 32 m². Me vendimin nr. ***, datë 9.11.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është vendosur “Pranimi i padisë, detyrimi i palës së paditur S. B që t'i kthejë palës paditëse B.R etj. pasurinë truall me sip. 32 m²”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër. Edhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga denoncuesja S. B.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin e datës 21.5.2014, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit për vendimin e gjykatës së datës 9.5.2010, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Dy herë ka dështuar procesi i ekzekutimit për shkak të vështirësisë së përcaktimit të pozicionimit të sip. 32 m² sipas vendimit të KKKP-së dhe faktit, si dhe për shkak se ishte e pamundur që të kthehej sipërfaqja e truallit në ndërtesë pa u dëmtuar ndërtesa. Ndërsa, në kohën kur pala kreditore i është drejtuar përmbarueses E. M për t'u kthyer pronën kreditorëve, ajo ka zhveshur debitorët nga posedimi i dyqanit, duke vënë kreditorët në posedim jo vetëm të truallit prej 32 m², por edhe të dyqanit me sip. 50 m², së bashku me gjithë mallrat që ndodheshin në dyqan, që i përkisnin aktivitetit ekonomik që ushtronte paditësi civil B.B (i biri i denoncueses).

Sipas denoncueses, përmbaruesja, në kundërshtim dhe në shkelje të neneve 510 e 511 të Kodit të Procedurës Penale, ka tejkaluar detyrimin e përcaktuar në titullin ekzekutiv “Lirimi i sipërfaqes së truallit prej 32 m²”, duke zhveshur nga posedimi paditësen S. B jo vetëm nga trualli, por edhe nga dyqani dhe mallrat që ndodheshin në të.

Në analizë të vendimit nr. ***, datë 9.11.2010, të gjyqtarit Bezart Kaçkini, ai ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e palës së paditur S. B për t’i kthyer palës paditëse pasurinë truall me sip. 32 m²”, me argumentimin se sipas aktit të ekspertimit dhe nga këqyrja në vend, si dhe nga krahasimi i pamjes së sotme me fotot e vjetra të marra nga fototeka “****”, arrihet në konkluzionin se nuk ka asnjë ndërtim të ri sipas lejes së ndërtimit të datës 16.1.1991, në favor të Sh. B (e cila ia ka shitur S. B). Objekti dyqan është një prej objekteve të përmendura në vërtetimin e pronësisë së vitit 1951 në favor të Sh. D. M. dhe në të janë bërë vetëm disa riparime dhe një shtesë objekti aktual me sipërfaqe truall 32 m², në favor të familjes R.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim të arsyetuar e në respekt të dispozitave procedurale.

Ndërsa, siç përmendet edhe nga denoncuesja, por edhe nga dokumentacioni bashkëlidhur, evidentohet se në vitin 2019 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka kërkuar procedimin penal të përmbarueses E. M për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për shkak se sendi i luajtshëm kthehet vetëm në ato raste kur është i lirë dhe i mundshëm për t’u kthyer e, në rastin konkret, mbi pasurinë truall ishte dyqan dhe mallrat në të. Prandaj, Prokuroria ka arritur në konkluzionin se nga ana e përmbarueses gjyqësore është vepruar në shkelje të hapur të ligjit gjatë ekzekutimit të vendimit të formës së prerë me nr. ***, datë 24.3.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 6.7.2020, ka vendosur “Rrëzimin e kësaj kërkesë dhe pushimin e procedimit penal në ngarkim të përmbarueses gjyqësore E. M”.

Sa më sipër, referuar arsyetimit të vendimit dhe respektimit të dispozitave procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk kishte *indicie* të mëtjshme për të hetuar në lidhje me këtë denoncim.

21.3 Denoncim nr. * prot., datë 21.9.2018, i shtetasit B.D**

Denoncuesi i drejtohet Komisionit me denoncimin për gjyqtarin Bezart Kaçkini, pasi ai, sipas tij, në datën 14.6.2018 ka marrë një vendim kriminal dhe të paprecedentë që, sipas denoncuesit, e ka dëmtuar rëndë në të drejtat e tij ligjore për përfitimim e shpërblimit të dëmit shëndetësor, shpërblim për të cilin Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë i kanë dhënë të drejtë. Gjithashtu, denoncuesi ka pretenduar se gjyqtari B. Kaçkini nuk ka respektuar detyrat që i janë lënë nga Gjykata e Lartë në lidhje me kryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm, duke listuar edhe shkeljet ligjore të pretenduara në vendimin e sipërcituar⁴³.

Rrethanat e çështjes

Denoncuesi është mobilizuar në ushtri, në datën 20.2.2000, në F.U.D, reparti ushtarak nr. ***, Durrës (sot komanda e repartit ushtarak nr. ***). Në datën 23.11.2000, kërkuesi është aksidentuar rëndë gjatë pastrimit të teknikës ushtarake. Si rrjedhojë e këtij aksidenti, ai është invalid i përhershëm i grupit të parë. Për shkak të pamundësisë së kurimit në vend, nga F.A janë marrë masat për dërgimin dhe shtrimin e tij në një spital në Firence, Itali, ku është kuruar (sipas kartelës mjekësore) dhe ka kryer 13 ndërhyrje kirurgjikale në periudhën dhjetor 2000 – janar 2007.

Në vitin 2007, denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit të shëndetit, kërkesë e cila u rrëzua nga gjykata me vendimin nr. *** akti, datë 14.2.2007, me arsyetimin se kërkuesi ka mundësi të tjera ligjore për kërkimin e të drejtës së tij. Në datën 5.3.2007, z. D i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me objekt “Shpërblimin e dëmit shëndetësor nga aksidenti i datës 22.11.2000, për shumën 9,650,000 lekë”, me palë të

⁴³ Vendimi nr. ***, datë 14.6.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

paditur Ministrinë e Mbrojtjes dhe komandën e repartit ushtarak ***, Durrës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 10.12.2007, vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit të parashikuar në ligj dhe, si e tillë, duhet rrëzuar si e parashkruar.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.6.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm, me të njëjtin arsyetim, por duke evidentuar edhe faktin se çështja përbën gjë të gjykuar, pasi kërkuesi i është drejtuar gjykatës edhe më parë me kërkesë për rivendosje në afat për ngritjen e padisë për shpërblimin e dëmit të shëndetit, kërkesë e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. *** akti, datë 14.2.2007.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 26.6.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

Denoncuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 24.4.2013 me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve të marra gjatë procesit gjyqësor civil të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ku në fund ka vlerësuar se pretendimet e z. D për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë proceseve gjyqësore të zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë pjesërisht të bazuara e, për këtë arsye, ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 26.6.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me anë të vendimit nr. ***, datë 27.9.2017, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 23.6.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. ***, datë 10.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”. Referuar shortit pranë kësaj gjykate, gjyqtar është caktuar subjekti i rivlerësimit. Ky i fundit pas shqyrtimit në themel dhe analizimit të çështjes në lidhje me ligjshmërinë ka vlerësuar se padia është paraqitur jashtë afatit dhe me vendimin nr. ***, datë 14.6.2018, ka vendosur “Mospranimin e kërkesëpadisë së paditësit B. D” etj.

Duke parë arsyetimin e këtij vendimi që subjekti i rivlerësimit ka bërë, Komisioni, në referim të aftësive profesionale⁴⁴ të gjyqtarit B. Kaçkini, analizoi edhe dy vendimet e Gjykatës së Lartë dhe atë të Gjykatës Kushtetuese⁴⁵, nga ku konstatoi se pretendimet e denoncuesit për mosrespektimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë nuk qëndrojnë, sepse kërkesa për rigjykimin e çështjes së shtetasit B.D nuk kishte të bënte me themelin e çështjes, por me të drejta të tjera procedurale të pretenduara të shkelura përgjatë gjykimeve në gjykatat më të larta, siç është e drejta për një proces të rregullt ligjor⁴⁶. Nga ballafaqimi me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese nr. ***, datë 2.12.2013, si dhe atë të Gjykatës së Lartë, përfundimisht arrihet në konkluzionin se nuk qëndron pretendimi i denoncuesit për mospërbushje të detyrave të lëna nga këto dy gjykata të sipërcituara. Përkundrazi, vetë shqyrtimi i kësaj çështjeje është përmbushje e kërkesës së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që ka të bëjë me procesin e rregullt ligjor. Ndërsa vendimmarrja është proces analize provash e faktesh në lidhje me rrethanat e ngjarjes së ndodhur, për të cilën paditësi i drejtohet gjykatës.

⁴⁴ Referuar nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁵ Vendimi nr. ***, datë 27.9.2017, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr. ***, datë 2.12.2013, i Gjykatës Kushtetuese.

⁴⁶ 28. Gjykata, nisur edhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se *prima facie* mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të së drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes nuk ka kryer shkelje procedurale dhe nuk paraqet mangësi profesionale, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale. Ndërsa, në lidhje me vendimmarrjen e gjyqtarit për çështjen në themel, Komisioni nuk mund të vlerësojë korrektësinë e vendimit dhe logjikën e përdorur nga ana e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të çështjes.

21.4 Denoncim nr. * prot., datë 6.2.2019, i shtetasit P Sh**

Denoncuesi i drejtohet Komisionit me denoncimin për gjyqtarin Bezart Kaçkani si kryesues dhe dy gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës Administrative, anëtarë në një çështje ku denoncuesi është administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e palës paditëse në proces kundrejt palës së paditur – Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë “M. H.” sh.p.k. Denoncuesi citon vendimin nr. ***, datë 12.11.2017, duke thënë se: *“Ky vendim është në kundërshtim të hapur dhe të plotë me ligjin për këto arsye: ekziston kontrata koncesionare e paditësit me datë 9.9.2013, me nr. ***/***, ku cilësohet se përroi i X nga kuota 31350 e poshtë deri në aksin e lumit Mat është pjesë e kontratës së koncesionit të vitit 2013 të shoqërisë “****” Trupi gjykues në vendimin e marrë citon në faqen 2 të tij se përroi i X është pjesë e kontratës koncesionare të paditësit “****”. Po kështu, në të gjitha provat dhe shkresat e Ministrisë së AKBN është e cituar se përroi i X është pjesë e këtij koncesioni të paditësit të vitit 2013. Kurse në fund Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova”.*

Sipas denoncuesit: *“Ky vendim është absurd dhe i çuditshëm, sepse gjykata ndryshe argumenton dhe ndryshe vendos. Dhe një fakt tjetër është edhe mosmarrja e një eksperti teknik, të kërkuar për të zbardhur se kujt i takonte përroi i X. Ministria, tri vite më vonë, në vitin 2016, e merr përsëri përroin e X dhe ia jep shoqërisë “M. H.” sh.p.k., duke krijuar mbivendosje të kontratave dhe të pellgut ujëmbledhës”.*

Bashkëlidhur këtij denoncimi, gjenden vendimi i sipërcituar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku gjyqtari Bezart Kaçkani ka qenë një ndër tre gjyqtarët e çështjes, pikërisht kryesues i trupit gjyqësor, si dhe dokumenti “Oponenca teknike mbi projektet e zbatimit të hidrocentraleve të kanalit ujitës “****” të shoqërisë koncesionare “****” sh.p.k.”, me nr. *** prot., datë 5.12.2014.

Në analizë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë⁴⁷ vërehet se denoncuesi në cilësinë e palës paditëse i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadinë “Detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, të zbatojë kontratën e koncesionit të formës “****” të datës 9.9.2013 dhe deklarin të pavlefshëm të kontratës shtesë koncesioni të vitit 2016, e lidhur midis palëve të paditura Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë “M. H.” sh.p.k., për sa i përket nenit 3, të titulluar “Karakteristikat e hidrocentraleve”, të emërtuar “****” (përroi X)”.

Pas nënshkrimit të kontratës koncesionare të datës 9.9.2013, pala paditëse ka kërkuar miratimin dhe zbatimin e projektit nga autoriteti kontraktues. Ministria e Energjisë dhe Industrisë e ka zvarritur pa shkaqe ligjore këtë qëndrim të mbajtur prej një periudhe rreth 3-vjeçare dhe, pas 3 vitesh, autoriteti kontraktues, në mënyrë arbitrare sipas paditësit, ka vendosur që përroi X, i cili i është dhënë palës paditëse me koncesion për ndërtimin e hidrocentralit nr. ***, t’ia japë në kundërshtim me ligjin, me koncesion shoqërisë “M. H.” sh.p.k. Nga ana tjetër, pala e paditur i ka kërkuar në mënyrë konsistente shoqërisë “****” sh.p.k. të paraqiste projektin e zbatimit pranë AK në përputhje me parametrat e përcaktuar sipas kushteve të kontratës. Në asnjë pikë të kontratës koncesionare nuk përcaktohet se sheshi i ndërtimit të hidrocentralit do të ishte edhe përroi X.

Gjykata në vlerësimin e saj ka cituar dokumente e prova që vërtetojnë të kundërtën e pretendimeve të denoncuesit dhe në përfundim të procesit ka vendosur rrëzimin e

⁴⁷ Vendimi nr. ***, datë 12.11.2017.

kërkesëpadiisë, duke vlerësuar se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara në ligje e prova.

Sa më sipër, referuar nenit pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës⁴⁸, Komisioni mori në konsideratë një nga elementet përbërës të aftësive profesionale të gjyqtarit B. Kaçkini, sipas parashikimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik në drejtim të arsytimit të vendimit (objekt denoncimi) dhe, pa gjykuar korrektësinë e vendimmarrjes, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar paaftësi apo mangësi në tregues të tillë që të ndikojnë në vlerësimin e aftësive profesionale të tij.

Në këto kushte, nuk kishte *indicie* për hetim të mëtejshëm, duke shtuar edhe faktin se subjekti i rivlerësimit ka qenë një ndër tre gjyqtarët e çështjes, si dhe vendimi i një gjykate më të ulët është gjithmonë objekt ankimi në një gjykatë më të lartë.

21.5 Denoncim nr. * prot., datë 5.11.2020, i shoqërisë “***” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori M.K**

Administratori i përgjithshëm i kësaj shoqërie nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të saj i është drejtuar KLGJ-së dhe Komisionit me një ankesë ndaj trupit gjykues të përbërë nga kryesuese gjyqtare znj. S. H., z. G. M. dhe z. Bezart Kaçkini të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për shkak se janë dëmtuar në mënyrë flagrante interesat e ligjshëm të shoqërisë “***” sh.p.k. nga ky trup gjykues.

Shoqëria “***” sh.p.k. ka qenë përfaqësuese e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOT), të përbërë nga vetë ajo dhe shoqëritë “***” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., i cili ka hyrë në një marrëdhënie kontraktore me Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së prokurimit të datës 21.2.2017, me objekt “Përmirësimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike në fushën penale”. Gjatë zbatimit të kësaj kontrate ka lindur një konflikt ndërmjet palëve dhe, në të tilla kushte, nga ana e B.O.E është iniciuar procesi gjyqësor administrativ, me palë paditëse (e kundërpaditur) B.O.E dhe palë e paditur (kundërpaditëse) M.D. Kjo çështje është regjistruar në datën 2.5.2019 dhe, sipas shortit, i është caktuar gjyqtarës relatore S. H. Denoncuesi përmend shkelje flagrante të gjyqtarës relatore dhe në fund shpjegon se, pasi gjykata vendosi rrëzimin e kërkesëpadiisë, edhe pse kanë kaluar 28 ditë nga dhënia e dispozitivit të vendimit, për shkak të veprimeve procedurale të paligjshme të kryetares së trupit gjykues, znj. S. H., duke rënë ndesh me parashikimet e nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, i cili detyron kryetarin e seancës të dorëzojë në sekretari vendimin e arsytuar jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e dispozitivit të tij. Bashkëlidhur ankimit të tij, denoncuesi ka sjellë edhe kopje të kalendarit të seancave nga sistemi elektronik i gjykatës.

Sa më sipër, në referim edhe të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ky denoncim nuk mund të trajtohet më tej për shkak të mungesës së të dhënave konkrete, të cilat të mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

21.6 Denoncim nr. * prot., datë 1.12.2021, i shtetases M.S**

Kjo shtetase u është drejtuar disa institucioneve të drejtësisë dhe Komisionit gjithashtu. Ajo ankohet ndaj gjyqtarit Bezart Kaçkini sa i përket shkeljeve të rënda procedurale të kryera gjatë shqyrtimit të çështjes administrative në lidhje me vendimin e gjykatës, dhënë në seancën përgatitore të datës 22.11.2021, ora 9:00, për “Rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e ekspertit A.S, të caktuar nga gjykata në çështjen administrative nr. ***-2020”, në kushtet kur për të është bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga shtetasi Sh.S , përfaqësues ligjor i shtetases M.S për veprën penale “Ekspertimi i rremë”, parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal.

⁴⁸ Neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit”.

Sipas denoncueses, vendimi i gjyqtarit për mospërjashtimin e ekspertit A.S është një vendim i cili cenon rëndë njëanshmërinë në gjykimin e kësaj çështjeje. Bëhet fjalë për kërkesëpadinë e ngritur nga denoncuesja në cilësinë e paditëses, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shfuqizimin e vendimeve të vitit 2019 të kryetarit të Bashkisë Tiranë “Për miratimin e planit të detajuar vendor” në njësinë strukturore TR/*** për pjesën e transferimit të së drejtës për zhvillim në nënnjësinë *** për pasuritë e regjistruara në pronësi të saj dhe detyrimin e palës së paditur të përfshijë në këto vendime (PDV) njësinë strukturore TR/*** si nënnjësi për rihvillim/ristrukturim, pasuritë në pronësi të saj, ku gjykata me kërkesë të paditëses/denoncueses caktoi z. A.S -gjeodet si ekspert për kryerjen e një akti ekspertimi topografik dhe shtetasja E. G. – arkitekte, me licencë profesionale, si eksperte në fushën e planeve të detajuara vendore për kryerjen e një akti ekspertimi urbanistik, referuar pyetjeve të bëra nga paditësja. Nga akti i ekspertimit dhe shtesat e kërkuara mbi këtë akt, paditësja ka pretenduar se përgjigjet e ekspertit A.S janë të manipuluar dhe të pavërteta dhe, për këtë, ajo nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Sh. S., ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, duke e akuzuar atë për konsumimin e veprës penale, atë të “Ekspertimit të rremë”. Nga dokumentacioni bashkëlidhur rezulton se ky kallëzim është depozituar në datën 23.9.2021. Në denoncimin e saj, znj. S ka pretenduar se gjyqtari duhej të pranonte kërkesën për përjashtimin e ekspertit referuar nenit 72, pika 3 dhe 6 të Kodit të Procedurës Civile, duke argumentuar plotësimin e kriterëve, që parashikon ky nen.

Sipas procesverbalit të seancës së datës 22.11.2021, që denoncuesja ia ka bashkëlidhur denoncimit të saj, konstatohet se gjyqtari në këtë seancë ka verifikuar palët pjesëmarrëse në seancë, ndër të tjerë, edhe prezencën e dy ekspertëve A. S.- ekspert topograf dhe E. G. - ekspert urbanistik dhe ka relatuar se seanca e shkuar, ajo e datës 11.11.2021, është shtyrë me qëllim komunikimin e palëve në mungesë, me kërkesat, provat dhe aktet e ekspertimit të depozituara nga pala paditëse. Në këtë seancë, gjyqtari ka marrë vendimin e ndërmjetëm, “... duke mos pranuar kërkesën për përjashtimin e ekspertit A.S, me argumentimin se ajo është e pabazuar në ligj dhe se vendimmarrja e ekspertit do të analizohet së bashku me tërësinë e provave të tjera. Ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar”. Gjyqtari ndërpret seancën, për shkak se pala paditëse pas kësaj vendimmarrjeje për mospërjashtimin e ekspertit A.S ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtarit Bezart Kaçkini dhe ky i fundit duket se i jep mundësinë që kërkesën verbale ta materializojë me kërkesë me shkrim.

Komisioni mori në konsideratë një nga elementet përbërëse të aftësive profesionale të gjyqtarit B. Kaçkini, sipas parashikimit të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përkatësisht cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik në drejtim të arsytimit të vendimit (objekt denoncimi), duke e lidhur me analizën e rrethanave sa më sipër, referuar edhe kërkesave të nenit 72, pikave 3 dhe 6 të këtij neni, ku shprehimisht thuhet se: “3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; ...6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”. Sipas këtij neni (pikat 3 dhe 6), për sa kohë që pala në proces nëpërmjet përfaqësuesit të saj kishte paraqitur kallëzim penal në organin e prokurorisë, duket se zgjidhja optimale e mundshme e gjyqtarit do të ishte pranimi i kërkesës për përjashtimin e ekspertit A. S., për shkak të një logjike tashmë të pamundësisë së vazhdimit të procesit në ato kushte të dëmtuara të mirëbesimit reciprok.

Sa më sipër, Komisioni konstatoi se, pavarësisht momentit procedural të zhvillimit të procesit administrativ, procesi ishte drejt fundit dhe palët po ballafaqonin konkluzionet përfundimtare. Gjithashtu, pavarësisht faktit se vendimi objekt denoncimi ishte vendim i ndërmjetëm dhe se vendimi përfundimtar do të bazohej në jo më pak se dy akte ekspertime, si dhe në fakte, prova e dokumente të tjera, duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi të argumentimit logjik në drejtim të arsytimit të vendimit të ndërmjetëm të datës 22.11.2021.

Lidhur me këtë konstatim sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të jepte shpjegime, si dhe informacion për statusin aktual të kësaj çështjeje

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Me shortin e datës 1.6.2020, më është caktuar për gjykim çështja me palë ndërgjyqëse: paditës M.S , i paditur Bashkia Tiranë. Në vijim të veprimeve përgatitore me kërkesë të paditësit është marrë vendim për marrjen e provës me ekspert të fushës së urbanistikës dhe topografi-gjeodezisë. Për këtë qëllim është caktuar si ekspert topograf ing. A. S. dhe ekspert urbanist ing. E. G. Në përgjigje të pyetjeve të palëve dhe të miratuara nga gjykata, ekspertët kanë përpiluar aktin e ekspertimit dhe shtesat, të dorëzuara në gjykatë në datat 19.10.2020, 16.1.2021, 8.4.2021, 14.6.2021, 30.7.2021 dhe datë 16.9.2021. Duke pasur pretendime për konkluzionet e ekspertit topograf A. S., pala paditëse ka kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Tiranë ekspertin A. S., duke e kallëzuar për “Ekspertim të rremë”. Kallëzimi është bërë në datën 23.9.2021, ndërsa në seancën e datës 22.11.2021 është shtruar për diskutim kërkesa e depozituar në Gjykatën Administrative për përjashtimin e ekspertit A. S. Përjashtimi kërkohet me arsyetimin se kishin ushtruar të drejtën për kallëzim penal ndaj ekspertit. Po në këtë seancë kam shqyrtuar kërkesën dhe, pasi kam dëgjuar palët dhe ekspertin, kam vendosur rrëzimin e kërkesës. Si arsyetim kam përdorur faktin që kërkesa vinte pas dorëzimit të aktit të ekspertimit, çka përjashtonte mundësinë që eksperti të ishte i njëanshëm, për shkak se ai tashmë e kishte dhënë mendimin e tij në aktin e ekspertimit dhe shtesat që u ishin bërë me dije palëve dhe ishin debatuar në prani të tyre. Po ashtu, kam arsyetuar se në çdo rast gjykata e merr vendimin pas analizës së tërësisë së provave shkresore dhe jo vetëm, ku mes tyre do të ishin dhe akti i ekspertimit së bashku me shtesat. Në refuzimin e përjashtimit të ekspertit kam pasur në konsideratë edhe kohëzgjatjen e procesit, sjelljen e palës paditëse, si dhe fazën në të cilën ndodhej gjykimi. Kam bindjen që për rrethanat konkrete kjo ishte zgjidhja më e përshtatshme dhe në interes të drejtësisë. Gjithsesi, e gjej të drejtë vlerësimin e Komisionit në drejtim të arsyetimit të vendimit. Mbase do të duhej të kisha dhënë arsye shteruese për palët në seancë. Gjithsesi, më lejoni të parashtroj se pala paditëse të njëjtën ankesë drejtuar KPK-së ia ka adresuar, veç të tjerëve, edhe ILD-së, e cila, pasi nuk ka konstatuar shkelje të magjistratit⁴⁹, ka vendosur ta arkivojë atë.*

*Lidhur me statusin e çështjes, ju informoj se nga pala paditëse më është bërë me dijeni ankesa e depozituar në disa institucione, mes të cilave edhe KPK dhe ILD. Me ndërgjegje të pastër dhe për të mos paragjykuar çdo vendimmarrje timen, i kam parashtuar kryetarit të Gjykatës kërkesën për heqje dorë nga gjykimi. Me vendimin nr. ***, datë 18.1.2022, nga kryetari i Gjykatës më është pranuar kërkesa dhe çështja është rishortuar. Më rezulton se çështja është rishortuar sërish, derisa me vendimin nr. ***, datë 11.1.2023, është disponuar pranimi i pjesshëm i kërkesëpadisë. Kundër vendimit kanë ushtruar ankim paditësi dhe i padituri dhe aktualisht çështja është në pritje të gjykimit pranë Gjykatës së Apelit Administrativ”.*

Në analizë të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë denoncim, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e paraqitura nga subjekti ishin të plota dhe të qarta. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer shkelje procedurale në drejtim të respektimit të të drejtave të palëve në proces, si dhe të veprimeve procedurale në drejtim të menaxhimit efikas të procesit gjyqësor, të drejtë e të bazuar në ligj.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

22. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁹ Me vendimin nr. *** prot., datë 31.3.2022, sjellë nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve përfundimtare.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Bezart Kaçkini ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bezart Kaçkini, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 11.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi